



Mbikëqyrja parlamentare
e ekzekutivit

Implementimi i ligjit për shëndetësi
Marrëdhëniet midis Sllovenisë dhe Kosovës
ngriten në nivel më të lartë

EDITORIAL



Me emërimin e z. Hasan Preteni si Drejtor të Agjencisë Anti-korrupsion me 19 qershor 2006, Kuvendi i Kosovës mori një vendim tejet të rëndësishëm në mbështetje të luftës kundër korrupsionit në Kosovë. Ndërsa tani shpresojmë se Kuvendi do ta vazhdojë mbështetjen për një fillim të mbarë të punës së kësaj Agjencie, posaçërisht në kohën kur janë ngritur shqetësime lidhur me buxhetin e limituar të Agjencisë për vitin 2007. Së këndejmi, ne shpresojmë se artikulli i z. Pretenit, në këtë Buletin Informativ të ASI-it, do të kontribuojë në rritjen e mbështetjes së Agjencisë për përballjen me detyrat dhe sfidat monumentale me të cilat do të ndeshet kjo Agjenci.

Në raportin e fundit të UNDP-së, bëhet e ditur se një nga arsyt kryesore të mungesës së besimit të qytetarëve në institucionet e Kosovës është përhapja e gjerë e korrupsionit. Për më tepër, sipas gjykimit të qytetarëve korrupsioni është i përhapur jo vetëm tek institucionet publike, por edhe në sektorin privat. Nëse nuk ekziston besimi në këto institucione, nuk mund të ketë demokraci të qëndrueshme në Kosovë. Lufta kundër korrupsionit është një punë e tejet e rëndësishme dhe e domosdoshme. Strategjia Anti- Korrupsion, e miratuar nga Qeveria me 17 mars 2004 është e një rëndësie të veçantë, ngase përmes saj pranohet publikisht jo vetëm ekzistenca e korrupsionit në Kosovë, por edhe pasojat e shoqërore nga kjo dukuri e shëmtuar. Veç kësaj, me 7 shkurt 2006 Qeveria shpalli Planin e detajuar të veprimit kundër korrupsionit. Ndërkaq, tani pritet që Kuvendi, nga njëra anë, ta mbështesë zbatimin e këtij Planin dhe, nga ana tjetër, t'i mbikëqyrë përpjekjet dhe punën e Qeverisë rreth zbatimit të këtij Plani.

Në epiqendër të vëmendjes së edicionit të 25-të të Buletinit Informativ ASI janë tri ligje të miratuara kohëve të fundit nga Kuvendi: Ligji për gjuhët zyrtare, Ligji për liritë fetare dhe Ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Këto tri ligje janë cilësuar si prioritarë në mesin e standardeve të përcaktuara nga Grupi i Kontaktit në procesin e përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës. S'do mend se me miratimin e këtyre ligjeve, të cilat u përcollën me mjaft debate, Kosova është pajisur me një kornizë ligjore që ka rëndësi shumë të madhe për bashkëjetesën e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Në fund, mbetemi me shpresë se artikujt dhe shkrimet lidhur me këto ligje dhe zhvillimet parlamentare do të jenë me interes për ju, sidomos tani kur Kuvendi është duke hyrë në një vit të ri, gjatë të cilit statusi i Kosovës dhe faza e tranzicionit do të jenë preokupimi dhe sfidat kryesore të Kuvendit.

*Franklin De Vrieze,
Koordinator i "Iniciativës për Përkrahjen e Kuvendit"*

Editorial	2
Marrëdhëniet midis Sllovenisë dhe Kosovës ngriten në nivel më të lartë	3
Mbikëqyrja Parlamentare e Ekzekutivit	4
Kosova duhet tu ofrohet përvojave të Parlamentarizmit evropian	6
Mbikqyrja në seancë plenare, koha për pyetje, interpelanca dhe forma tjera të debatit	6
Mbikëqyrja ekzekutivit përmes komisioneve funksionale dhe hetimore	7
Kosova ka nevojë për qartësi të statusit të ardhshëm të saj	8
Procesi kushtetues dhe roli i kuvendit	10
Kushtetuta – Ndermarrje e perbashket madhore	10
Ligji për trashëgiminë kulturore	11
Ligji mbi lirinë e fesë: hapat e ardhshëm	11
Rëndësia e zbatimit të ligjit mbi gjuhët	12
Zbatimi i ligjeve në mënyrë serioze	13
Shkalla e implementimit dhe jetësimit të ligjit për shëndetësi	14
Parlamenti dhe media: a është i mundshëm partneriteti?	16
Agjensioni Kosovar i Antikorrupsionit	18
Mbështetja e OSBE-së Kuvendit të Kosovës	20
Komisioni për Bugjet dhe Financa përpilon propozimin për buxhetin e Kuvendit për vitin 2007	23



Marrëdhëniet midis Sllovenisë dhe Kosovës ngriten në nivel më të lartë

Mr. France Cukjati, M.D. Kryetar i Asamblesë Nationale të Republikës së Sllovenisë

Sllovenia gjithnjë ka pasur marrëdhënie të mira me Kosovën. Qysh në kohën kur ishim pjesë e Jugosllavisë, Sllovenia i ka mbështetur përpjekjet dhe aspiratat e popullit të Kosovës për të siguruar më shumë të drejta dhe demokraci. Së këndejmi, Sllovenia edhe tani dëshiron të kontribuojë rreth demokratizimit të Kosovës dhe arritjes së një statusi të atillë të Kosovës, i cili do të ishte në përputhje me vullnetin e popullit të saj dhe që njëherësh do t'i kontribuonte paqes dhe stabilitetit në rajon.

Vlen të vihet në dukjes se Kuvendi i Republikës së Sllovenisë me kënaqësi është duke bashkëpunuar me parlamentet e Maqedonisë dhe Malit të Zi për t'u ardhur në ndihmë këtyre parlamenteve në procesin e integritit të tyre në Bashkimin Evropian. Ndërkaq, vitin e shkuar Kuvendi i Sllovenisë u bë pjesë e konsorciumit të parlamenteve të Francës, Gjermanisë dhe Belgjikës për të zbatuar projektin për mbështetjen e mëtejme të Kuvendit të Kosovës.

Sipas marrëveshjes së arritur me konsorciumin, Kuvendi i Sllovenisë ka marrë mbi vete përgjegjësinë për të siguruar duke u mbështetur në përvojën e fituar si gjatë integritit në institucione Euro-Atlantike ashtu edhe gjatë procesit të harmonizimit të legjislacionit slloven me *acquis communautaire*- mbështetje për Kuvendin e Kosovës lidhur me shtimin e transparencës,



Kryetarët Berisha dhe Cukjati gjatë vizitës së Kryesisë së Kuvendit në Slloveni

kontrollin e buxhetit të shtetit, organizimin e aktiviteteve të grupeve parlamentare, dhe organizimin dhe funksionimin e aktiviteteve hulumtuese dhe arkivave.

Prandaj, me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit ka pasur shkëmbime të rregullta të ekspertëve të fushave të sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe vizitën studimore që delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i prirë nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kolë Berisha, i ka bërë Kuvendit të Sllovenisë nga data 17 deri me 19 shtator 2006.

Gjatë bisedave me Kryetarin Berisha ne i shprehëm mbështetjen tonë politike për përpjekjet e tyre për të arritur paqen dhe pavarësinë. Në fakt ne të gjithë e kemi të qartë se demokratizimi, pavarësia dhe integrimi në BE janë tri aspekte të një procesi të njëjtë. Kështu që, asnjëra nga këto nuk mund të ekzistojë pa tjetrën. Pra, nuk mund të ketë demokratizim të mëtejme pa një shkallë më të lartë të pavarësisë dhe pa një perspektivë të integritit në EU. Po kështu, nuk mund të ketë pavarësi pa demokratizim apo evropianizim të sistemit shtetëror.

Në Kosovë duhet të krijohet një ambient ku do të mbretërojë liria politike, paqja dhe bashkëjetesa. Ndaj, është me rëndësi që të vazhdohet me krijimin e një sistemi kushtetues dhe legjislativ, që i përmbushë kriteret e BE-së. Veç kësaj, është me rëndësi që autoritetet të garantojnë sigurinë dhe mbrojtjen e pakicave, sidomos të pakicës serbe, dhe që të vazhdojnë përkushtimin e tyre për të biseduar me Beogradin dhe për të gjetur një zgjidhje që do të jetë e pranueshme për të dy palët. S'ka pikë dyshimi se pala që do të jetë më konstruktive në



bisedime dhe që do të insistojë në zgjidhje paqësore do të ketë më tepër mirëkuptim nga BE-ja, gjë e cila do të ketë ndikim edhe në vendimet politike, që do të merren.

Duke e ndjekur një rrugë transparente dhe duke u impenjuar për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore të statusit, populli i Kosovës do të faktojë se është i pjekur për të krijuar shtetin e vet. Njëherësh, shpresoj se komuniteti ndërkombëtar do të dijë ta çmojë një orientim të këtillë të Kosovës dhe do ta respektojë vullnetin e popullit të Kosovës, statusi i të cilit do të zgjidhet së shpejti.

Slovenia është thëllësisht e interesuar në vendosjen e paqes së qëndrueshme në Ballkan, ndaj dhe dëshiron që të forcojë bashkëpunimin e saj me vendin mik të saj Kosovën. Mementalisht në Kosovë janë duke shërbyer 160 pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Sllovenisë, ndërkaq në fillim të vitit 2007 pritet të dislokohen edhe 640 trupa të tjerë (pjesëtarë të batalionit të motorizuar), për të siguruar transportin e komandës së KFOR-it në gjithë territorin e Kosovës.

Njëherësh, ne do të donim që aktivisht të kontribuonim në implementimin e planit për transferimin e kompetencave të UNMIK-ut tek autoritetet e Kosovës, por edhe atyre kom-

petencave që do të mbesin ende të rezervuara nga UNMIK-u e që duhet të transferohen tek MCN-ja (Misioni Civil Ndërkombëtar), gjë që pritet të ndodhë në fillim të vitit 2007. Ne jemi të sigurt se NATO është ende garantuesi kryesor i paqes në Kosovë dhe shpresojmë se do të vazhdojë të qëndrojë në Kosovë derisa të ketë garantohet përherë paqja dhe siguria.

Ndërsa, në rrafshin parlamentar ne po ashtu do të dëshironim që të kontribuojmë në promovimin e tolerancës, mirëbesimit dhe bashkëpunimit midis kombeve të ish Jugosllavisë. Koha kur Sllovenia do ta jetë kryesuese e radhës së BE-së, gjatë pjesës së parë të vitit 2008, do të jetë një mundësi e mirë për të ritheksuar dhe rikonfirmuar se dëshira e këtyre vendeve për integritet evropian është faktori vendimtar dhe forca kryesore lëvizëse e këtyre vendeve për të punuar me përkushtim të plotë në vendosjen e paqes dhe demokracisë në këtë pjesë të Evropës. Së këndejmi, gjatë kësaj kohe ne me kënaqësi do të organizonim një takim të kryetarëve të gjitha parlamenteve të vendeve të ish Jugosllavisë.

Në fund do theksuar se si Kosova ashtu edhe Serbia duhet të demonstrojnë vullnetin e tyre në mënyrë të qartë për t'iu bashkuar bashkësisë së shteteve të Evropës. Këtë më së miri mund ta faktojnë përmes vullnetit të tyre për t'i përfaquar dhe respektuar *acquis communautaire* dhe mënyrën evropiane të zgjidhjes së konflikteve. Ne besojmë se anëtarësimi i vendeve të Ballkanit në BE është garanti i vetëm për zhvillim, demokraci dhe paqe të përherëshme në këtë pjesë të Evropës.

Mbikëqyrja

Znj. Heike Baddenhausen-Lange,

Në sistemet parlamentare, funksionet e mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit mund të vështrohen nga kënde të ndryshme varësisht a shikohet në to nga këndvështrimi i opozitës apo nga këndvështrimi i shumicës/koalicionit. Kontrolli i ashpër është interesi i opozitës ndërsa partisë e shumicës/koalicionit tregohen të jenë më pak kritik. Por pozita e shumicës mund të ndryshojë, kështu që rregulla të lojës të drejta do të sigurojnë që procedura parlamentare po i respekton të drejtat e të gjithëve: të secilit anëtarë të Parlamentit, grupeve parlamentare, minoriteteve dhe interesin e përgjithshëm të mbarëvajtjes së punës së parlamentit.

Por mbikëqyrja parlamentare nuk është privilegj i opozitës por është në interesin e Parlamentit në tërësi dhe kontribuon në ushtrimin e kontrollit dhe mbajtjen e baraspeshës. Procedurat parlamentare mund tu shërbejnë qëllimeve të ndryshme p.sh. shërben për të marrë informacionin nga Qeveria, por njëkohësisht detyron Qeverinë që të sqarojë politikën në debate publike. Gjithashtu mundëson angazhimin parlamentar në fazat e hershme të politikave dhe prezantimin e koncepteve politike alternative, ku element qenësor është publiciteti dhe njohja e opinionit publik.

Ekspertët dhe anëtarët nga parlamentet e Belgjikës, Francës,

Gjermanisë dhe Sllovenisë të përfaqësuar në Konzorcium, i cili udhëhiqet përmes projektit të AER-it, kanë prezantuar qasjet e tyre dhe kanë sqaruar mënyrën sesi ata kanë zhvilluar procedurat dhe praktikën e tyre parlamentare. Ekziston nevoja që të gjitha parlamentet të krijojnë procedura të duhura për debate tematike dhe rregullimin e strukturave të debatit për nevojat e medias, për të marrë informacione dhe mbajtur kontrollin si p.sh. në legjislacionin buxhetor, zgjidhjet që janë bërë në parlamente ndryshojnë dhe reflektojnë traditën e ndryshme parlamentare. Në disa parlamente, grupet parlamentare luajnë një rol të rëndësishëm dhe parimi i përfaqësimit proporcional nuk reflektohet vetëm kur kemi të bëjmë me pozita të komisionit por edhe kur alokohet koha për të mbajtur fjalim. Struktura e komisioneve dhe procedura e draftimit të ligjeve gjithashtu dallojnë. Në anën tjetër praktika parlamentare zhvillohet dhe ekzistojnë interesa të përbashkëta për parlamentarët siç është p.sh. gjetja e mënyrës për të realizuar hulumtimin e nevojshëm dhe ngritur kapacitetet e informacionit dhe përballjet me burokracinë ministrore. Për këtë arsye mbështetja e dhënë nga Projekti i AER-it për Kuvendin e Kosovës përbëhet nga shkëmbimi i përvojave të parlamentarëve në çështjet procedurale dhe praktikën parlamentare dhe përqendrimi në rolin e administratës për të ofruar një mbështetje efikase parlamentare.

Parlamentare e Ekzekutivit

Eksperte nga Bundestagu Gjerman për projektin e AER / Përkrahje Kuvendit të Kosovës

Seminari synonte të ofrojë një platformë për të diskutuar pika të rëndësishme tematike në panele. Është treguar interesim nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të cilit dëshironin të raportonin mbi tema të ndryshme të paneleve. Z. Mazllom Kumnova raportoi në Panel me temat mbi Mbikëqyrjen e Ekzekutivit përmes komisioneve hetimore. Disa ditë më parë, Kuvendi i Kosovës kishte vendosur të formojë Komisionin hetimor. Një prej diskutimeve kishte të bënte me bazën ligjore të këtij lloji të posaqëm të komisionit. Përfundimi sipas z. Mazllom Kumnova është që njerëzit nuk duhet të nënvlerësojnë mekanizmat përmes Komisioneve të ndryshme drejtuese dhe komisionit hetimor për të mbikëqyrur ekzekutivin. Kuvendi, në anën tjetër duhet të

zhvillojë mekanizma të tjerë mbikëqyrës për llogaridhënien. Parlamentet evropiane duhet ti ndihmojnë Kosovës që të përballlet me këtë sfidë.

Znj. Safete Hadërgjonaj ka raportuar mbi Mbikëqyrjen e Buxhetit, përmirësimi i Kontrollit pas postit dhe para postit. Kjo temë është shumë tematik gjithashtu, meqë Kuvendi tani është në procesin e përmirësimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin që vjen. Kjo ka treguar që shkëmbimi gjatë prezantimeve dhe diskutimeve me Parlamentet e ndryshme Europiane që ka të bëjë me Procesin e Miratimit të Buxhetit dhe Mbikëqyrjen Parlamentare ishte shumë i dobishëm për Anëtarët e Kuvendit të Kosovës dhe shërbyesit civil të Kuvendit.

Panelet tjera raportuan përmes dy deputetëve të Kuvendit të Kosovës, z. Rrahim Demaj dhe z. Fatmire Mulhaxha-Kollçaku. Paneli mbi Implementimin e Legjislacionit ishte me interes të rëndësishëm tematik sepse Kuvendi i Kosovës pak kohë më parë kishte debatuar raportin mbi Implementimin e legjislacionit në sektorin e shëndetësisë. Një prej komisioneve drejtuese ka bërë shumë punë për të kontrolluar implementimin e legjislacionit.

Paneli mbi Mekanizmat Parlamentar të përshkruara në Rregulloren e Punës të Kuvendit të Kosovës, Koha e pyetjeve dhe Interpelanca ka ngritur çështjen e marrëdhënive mes Kuvendit

dhe Komisioneve të tij dhe Qeverisë. U bë e qartë që deputetët do të donin të shihnin një rol më aktiv të ministrave të ndryshëm për t'u përgjigjur pyetjeve dhe marrë përsipër përgjegjësinë për veprimet e tyre.

Pjesa e fundit e seminarit u përqendrua në Mbështetjen e Sekretariatit të Kuvendit të Kosovës. Është e qartë që Sekretariati duhet të riorganizohet që të ofrojë shërbime bashkëkohore dhe më shumë mbështetje profesionale për deputetët. Deputetët varen shumë nga puna e mirë e shërbyesve civil për të përmbushur detyrat e tyre si ligjvënës të mbikëqyrjes së ekzekutivit.

Si përfundim, mund të përsërisim që mbikëqyrja parlamentare është në interesin e parlamentit si tërësi dhe kontribuon në ushtrimin e kontrolleve dhe mbajtjen e baraspeshës. Gjithashtu procedurat parlamentare mund të shërbejnë për qëllime të ndryshme: Mbikëqyrja shërben për të marrë informacionin nga qeveria, dhe poashtu e detyron qeverinë që të japë sqarime mbi politikën në debat publik. Gjithashtu mundëson angazhime parlamentare në politika në fazën e hershme të tyre si dhe prezantimin e koncepteve të alternative politike ku element kyç për një gjë të tillë janë publiciteti dhe njohja e opinionit publik.

*Nga seanca përmbyllëse e seminarit më 14 nëntor 2006
(Naim Jerliu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Safete Hadërgjonaj, Mazllom Kumnova)*



Kosova duhet tu ofrohet përvojave të Parlamentarizmit evropian

Në kuadër të projektit për "Mbështetje të mëtejme për Kuvendin e Kosovës", OSBE dhe NDI organizuan seminarin "Mbikëqyrja Parlamentare mbi Procedurat Qeveritare tash dhe pas Statusit". Një nga temat e këtij seminari ishte "Mbikëqyrja e buxhetit – përmirësimi i kontrollit nga e kaluara në të tashmen". Për këtë temë ligjëruan Z. David Geerts, AP (dhoma e përfaqësuesve Belgjan), dhe Joze Koncan (sekretar i komisionit për kontroll në Slloveni).

Në Parlamentin Belg edhe në Parlamentin Slloven, miratimi i buxhetit ishte një nga detyrat kryesore të parlamentit çështja që më së shumti kërkon punë, angazhim të të gjithë deputetëve sidomos të të gjitha komisioneve parlamentare e në veçanti të komisionit për buxhet. Në të dy këto vende debatet për buxhet ishin ngjarjet më të theksuara gjatë një viti parlamentar.

Tek ne zakonisht buxheti që na është ofruar është hartuar sipas një praktike rutinë edhe miratimi i tij në Kuvend ka qenë pjesë e kësaj rutine.

Edhe pse sipas legjislacionit në fuqi PSSP rezervon pushtetin e transferit të fondeve pa kërkuar pëlqimin e Kuvendit, sepse është autoriteti i fundit për miratimin e buxhetit, një gjë e tillë nuk është dashur apo nuk duhet të jetë shkak që buxheti të miratohet me nguti siç ka ndodhur në vitet paraprake e sidomos në

vitin e kaluar ku shqyrtimi i projekt buxhetit ka qenë në mesin e 16 pikave të rendit të ditës së seancës së 15, 16 dhe 19 dhjetorit të vitit 2005. Shqyrtimi i parë dhe miratimi i buxhetit është bërë në të njëjtën seancë. Praktika e miratimit me nguti e projekt ligjit për buxhet që është ligji më i rëndësishëm nuk është e mirë dhe duhet ndërprerë. Kuvendi duhet të merr rolin që duhet ta ketë në miratimin e buxhetit dhe në mbikëqyrjen e shfrytëzimit të fondeve publike.

Nga ligjëruesit e këtyre dy vendeve kuptuam se projekt buxheti i dorëzohet me kohë Kuvendit dhe është objekt shqyrtimi i komisioneve sektoriale e posaçërisht i Komisionit për Buxhet e Financa. Në Parlamentin Belg secili komision sektorial shqyrton buxhetin bënë amendamentet dhe cakton nga një raportues që do të raportojë në KBF. KBF disponon me të dhëna të detajuar për të ardhurat dhe shpenzimet të cilat i shqyrton në bashkëpunim të ngushtë me Ministrin e Financave.

Vija e komunikimit me MEF nuk është në nivel. KBF ka ftuar Ministrin e MEF me datë 11 tetor për të diskutuar lidhur me prioritetet buxhetore. Ministri nuk i është përgjigjur ftesës së komisionit.

Shtrohet pyetja a ka transparencë dhe a ka mbikëqyrje të buxhetit në Kosovë? Përgjigja është jo.

Gjatë qeverisjes së koalicionit qeverisës kanë ndodhur transfere të paligjshme nga një organizatë buxhetore në tjetrën, asnjë organizatë nuk ka shfrytëzuar mjetet sipas planit, duke mos qenë në gjendje për të përcaktuar objektivat zhvillimore mjetet për projekte investive janë harxhuar në blerjen e veturave apo në luks të

tepruar. Grupi parlamentar i PDK i shqetësuar për shfrytëzimin jo efektiv dhe jo efikas ka kërkuar formimin e komisionit hetimor që në shtator të vitit 2005, por kjo nuk është lejuar nga koalicioni.

Ministri i MEF asnjëherë nuk i ka raportuar komisionit funksional në lidhje me zbatimin e ligjit së paku një herë në vit siç është i obliguar sipas rregullës 53.2 të rregullores së punës së Kuvendit.

Sipas referimeve të përfaqësuesve Belg e Slloven, komisionet e sidomos KBF është në partneritet të vazhdueshëm me zyrën e auditorit dhe përmes auditimit bëhet përcjellja e vazhdueshme e shfrytëzimit me efektivitet dhe efikasitet të buxhetit.

Që të jemi më afër praktikave të parlamentarizmit të vendeve me traditë parlamentare sa i përket mbikëqyrjes buxhetore është nevojë e domosdoshme që:

- Procesi i hartimit të buxhetit të jetë objekti i debatit të gjerë me ekspertë dhe me qytetarë,
- Procesi i hartimit, miratimit dhe shfrytëzimit të buxhetit të jetë transparent, gjë e cila do të motivonte taksapaguesit të shlyejnë obligimet e veta,
- Komisionet funksionale të merren me seriozisht me projektbuxhetin,
- KBF të merr përgjegjësit të cilat ia ngarkon rregulla 51 e rregullores së punës së Kuvendit,
- KBF të merr përgjegjësitë e kontrollit të mjeteve publike
- KBF të ngritë nivelin e komunikimit me Zyrën e Auditorit Gjenerale.
- KBF të bëjë monitorimin e ligjeve bazike që rregullojnë menaxhimin e financave publik.

*Safete Hadërgjonaj, PDK
Anëtare e Kuvendit të Kosovës*

Mbikqyrja në seancë plenare, koha për pyetje, interpelanca dhe forma tjera të debatit

Pushteti në sistemet demokratike është i ndarë në pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ne parim këto pushtete janë të pavarura ne ushtrimin e funksioneve të saj. Megjithatë ato i nënshtrohen mbikëqyrjes së ndërsjellë. Kështu Qeveria përcakton politikën, Kuvendi miraton ato dhe i kodifikon ne ligje dhe gjyqësori përkuajdeset se ato ligje aplikohen dhe interpretohen ne atë frymë që janë miratuar pa favorizim të ndonjë pale. Njëra ndër kontrollat klasike të pushtetit është mbikëqyrja parlamentare, tematike. Mbikëqyrja e ekzekutivit ka për qëllim rritjen e efikasitetit të ushtrimit të pushtetit dhe krijimin e balancit ne mes të pushteteve. Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës gjithashtu është e pajisur me instrumente të kontrollit parlamentar të sprovuara ne praktikën e parlamenteve evropiane.

Është me rëndësi të theksohet se instrumentet e para para me Rregulloren e Punës për ushtrimin e mbikëqyrjes parlamentare i nënshtrohen procedurave fikse. Procedurat kane për qëllim te sigurojnë se këto instrumente janë përdorur për qëllime për të cilat ato janë krijuar.

Debati është e drejtë e garantuar e opozitës, ngase ky

është mjet i paraqitjes së pikëpamjeve të tyre lidhur me çështjet politike. Kjo e drejtë ushtrohet në forma të ndryshme, nëpërmjet:

-Pikave të rendit të ditës që i nënshtrohen formaliteteve dhe afateve kohore.

-Pyetjeve dhe përgjigjeve të deputetëve që i nënshtrohen poashtu formaliteteve.

-Interpelancave të grupeve parlamentare ndaj Qeverisë, respektivisht debateve të cilat janë të kufizuara dhe në proporcion me fuqinë parlamentare të grupit.

Praktika e pyetjeve dhe përgjigjeve është e ndryshme në formë, por jo edhe në parim. Kemi pyetje formale dhe joformale. Pyetjet formale parashtrihen paraprakisht, ndërsa ato joformale brenda seancës një ose dyorëshe, e paraparë për çështje aktuale. Kjo formë nuk është e paraparë në Rregulloren tonë. Prandaj, momentalisht

Kuvendi për shkak të kësaj mungese ndoshta shpesh po ballafaqohet me situata të fillimit të prolonguar të seancës për shkak të propozimeve të shumta për debat që pretendohet të futen në rend dite në fillim të seancës.

Gjithashtu, duhet të jetë e qartë se Interpelanca është debat e jo seancë e pyetjeve dhe përgjigjeve.

Në përmbyllje, do të mund të përfundohej se debati është çështje esenciale e parlamentarizmit. Si i këtillë, debati duhet të jetë i organizuar mirë dhe i orientuar nga grupi parlamentar, si dhe duhet të lejohet në bazë të proporcionit të fuqisë politike të grupeve parlamentare. Debati mundëson qasje më të mirë të shoqërisë në politikë, duke mundësuar që vendimarrja të bartet nga instancat individuale në Kuvend.

*Naim Jerliu, LDK
Anëtar i Kuvendit të Kosovës*

Isa Neziri (Drejtor i administratës të Kuvendit), Hugues de Courtivron (Udhëheqës Ekipi i projektit të AER-it 'Mbështetje e mëtutjeshme Kuvendit të Kosovës'), Ismet Krasniqi (Sekretar i Kuvendit) dhe Daut Beqiri (Drejtor i departamentit ligjor të Kuvendit)



Mbikëqyrja ekzekutivit përmes komisioneve funktionale dhe hetimore

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, më 14 nëntor 2006, me deputetët e Bundestagut të Gjermanisë, parlamentit të Belgjikës, të Francës dhe të Slovenisë, në kuadrin e projektit "Mbështetja e mëtejme për Kuvendin e Kosovës të sponsoruar nga OSBE dhe NDI, misionet në Kosovë, diskutuan në një panel të veçantë edhe tematikën "Mbikëqyrja përmes komisioneve funksionale dhe hetuese" të Parlamentit ndaj ekzekutivit.

Në problematikën e kësaj teme, deputet nga Kosova, kryesisht interesimin dhe diskutimin e tyre e orientuan sidomos në funksionin e Komisionit hetimor në parlament, duke u nisur nga ajo se Kuvendi i Kosovës, në seancën e fundit ka ngritur për herën e parë një komision të tillë. Edhe pse në mandatin e parë të Kuvendit të Kosovës është ngritur një komision i tillë, për arsyet e njohura nuk është vënë në funksion.

Për punë e komisioneve funksionale dhe atij hetimor, një përvojë e mirë është ekspozuar nga deputetja e Bundestagut gjerman z. Andrea Kerstges si dhe nga z. Alberik Goris, deputet i parlamentit të Belgjikës. Disa mendime dhe përvoja, deputetëve nga Kosova i përcolli dhe Franc Baron nga Ansambleja e Francës.

Një çështje tjetër që u debatua ishte edhe sa është niveli i gadishmërisë së Ekzekutivit që të

jetë prezent në Komisionet funksionale të parlamentit. Sidomos deputetët e Kuvendit të Kosovës shprehen pakënaqësinë e tyre për mosgadishmërinë e ekzekutivit, nivelin e ministrit dhe zëvendësministrit të merr pjesë në punën e komisioneve funksionale. Përndryshe është bërë dukuri që ministrat përfasqësohen me stafin civil, çfarë po zbehtë dhe motivimin e deputetëve për të debatuar ose për të kërkuar llogaridhënie nga ekzekutivi. Në këtë rast janë trajtuar edhe mundësitë se si mund të detyrohet ekzekutivi, sidomos ministrat dhe zëvendësministrat të marrin pjesë në punën e komisioneve funksionale kur ata janë të ftuar. Ndërsa për komisionin hetimor në raste të tilla zbatohet ligji i veçantë ose në rastin tonë në Kosovë rregullojta përkatëse për funksionimin e komisionit hetimor.

Në këtë temë janë hapur edhe çështje tjera, mirëpo kufizimi kohor i detyroj deputetët t'i hapin vetëm si çështje për ndonjë rast tjetër.

Një përfundim nga ky takim përafërsisht mund të ishte se nuk duhet nënvleftësuar mënyrat, mekanizmat dhe teknikat ekzistuese për mbikëqyrjen e ekzekutivit përmes komisioneve funksionale dhe atyre hetimor. Mirëpo, këto duhet të sofistikohen drejt mbikëqyrjes së ekzekutivit për llogaridhënie. Kjo do të mundësonte edhe një bashkëpunim më të mirë të legjislativit dhe ekzekutivit. Padyshim një objektiv i tillë nuk mbetet vetëm sfidë e Kuvendit të Kosovës, me një përvojë shumë të kufizuar por edhe parlamenteve të shteteve evropiane.

*Mazllom Kumnova, AAK
Anëtar i Kuvendit të Kosovës*

Kosova ka nevojë për qartësi të statusit të ardhshëm të saj

Përvoja ime në hartimin e kushtetutës

Lia Hani / Anëtare e Asamblesë Kushtetuese 1991-1992 / Republika e Estonisë



Kohë më parë kam shikuar një dokumentar për Kosovën në televizionin e Estonisë. Dokumentari ishte përgatitur nga disa të rinjë nga Estonia, të cilët kishin organizuar një kampim ndërkombëtar në Kosovë, qëllimi i të cilit ishte nxitja e mirëkuptimit midis komuniteteve të ndryshme të Kosovës. Duke e shikuar dokumentarin, mendoja se sa të vështirë e kanë dhe sa e ngjashme kishte qenë situata në Estoni para 15 vitesh. Atëbotë as që më shkante ndërmend se do të më jepej mundësia aq shpejtë për ta vizituar Kosovën. Kështu që, kur e morra thirrjen nga Misioni i OSBE-së në Kosovë për të marrë pjesë në hartimin e Kushtetutës së Kosovës si eksperte nuk kam hezituar asnjë moment. Gjatë rivendosjes së shtetësisë së Estonisë ne përjetuam të njejtat sfida dhe probleme, ndërsa gjatë kësaj kohe unë pata nderin dhe kënaqësinë

që të jem edhe anëtare e Asamblesë Kushtetuese, e cila e hartoi Kushtetutën e Estonisë. Ende kujtoj kohën kur punonim për realizimin e këtij objekti aq të rëndësishëm dhe aq të përgjegjshëm. Do të isha shumë e lumtur nëse përvoja e Estonisë do t'i hynte në punë popullit të Kosovës.

Ideja për hartimin e Kushtetutës së re të Estonisë dhe themelimin e Asamblesë Kushtetuese për këtë qëllim ka lindur me 1991, gjatë trazirave të gushtit, kur puqi në Moskë kërcënonte t'i shtypte dhe ngulfaste aspiratat e kombeve, të cilat kishin qenë pjesë e sistemit sovjetik. Godina e Parlamentit, e rrethuar me blloqe të mëdha të betonit (për të ndaluar depërtimin e tankeve), ishte vendi ku brenda disa orëve u kuptua se tanimë ishin pjekur kushtet për ta përcaktuar statusin e Estonisë dhe

njëherësh t'i jepej fund vaktit kushtetues. Vendimi për përcaktimin e "statusit shtetëror të Estonisë", i cili u miratua njëzëri me asnjë votë kundër, konfirmoi sovranitetin e Republikës së Estonisë dhe kësaj hapi rrugën për hartimin e Kushtetutës së re. Është për të ardhur keq që ky vendim historik u mor pa mbështetjen e kolegëve tanë rusë, ndonëse, përfaqësuesit e tyre morrën pjesë në punën e Asamblesë Kushtetuese.

Asambleja Kushtetuese përbëhej nga 60 anëtarë të grupeve dhe shtresave të ndryshme të shoqërisë estoneze si: njerëz nga nomenklatura e Partisë Komuniste, disidentë, njerëz të shtypur nga regjimi sovjetik, të cilët kishin kaluar vite të tëra në burgje si dhe përfaqësues të partive politike të themelura tevona. Të gjithë këta përfaqësues kishin në një Mision të përbashkët – të hartojnë Kushtetutën e Republikës së Estonisë brenda disa muajsh dhe të mbajnë referendumin për Kushtetutën. Mund të them se faktori vendimtar për një referendum të suksesshëm për Kushtetutën ishte pjesëmarrja e partive kryesore politike në procesin e hartimit të saj.

Kushtetuta nuk duhet të jetë dokument politik për përdorim njëditor. Së këndejmi, një nga detyrat më të ndërlikuar të Asamblesë Kushtetuese ishte që të mos lejo-

hej që konfliktet dhe situata e asaj kohe të ndikojë dhe të reflektohen në tekstin e Kushtetutës. Në fillim të sesionit të Asamblesë të gjithë anëtarët e dhanë betimin e tyre me rastin e marrjes së detyrës:

Si anëtarë i Asamblesë Kushtetuese unë e kam të qartë se punën time do ta vlerësojnë gjeneratat e ardhshme madje edhe pasi të jem shuar. Ndaj, frytet e punës sime rreth hartimit të Kushtetutës nuk mund të vlerësohen tani, por do të dëshmojnë gjatë historisë. Duke u bërë pjesë e Asamblesë Kushtetuese, unë e heq dorë nga aktiviteti im politik i mëparshëm. Tani do të punoj me ndërgjegje dhe do të impenjohem që të bëhem pjesë e historisë.

Megjithatë, ka pasur raste kur anëtarët e Asamblesë nuk kanë qenë në gjendje ta lënë politikën mbrapa dyerve të sallës së mbledhjeve. Megjithatë, kryesuesi i Asamblesë i tejkallonte këto situata, duke i dhënë debatit kahje konstruktive. Është kënaqësi kur puna e përbashkët udhëhiqet nga një person me nerva të çeliktat, sens të veçantë jo vetëm për misionin dhe detyrën që ka, por edhe për të bërë humor nganjëherë me qëllim të tejkallimit të disa situatave të vështira. Vetë fakti se disa anëtarë të Asamblesë nuk ishin drejtpërdrejt të implikuar në politikë ditore pati një efekt balancues dhe kjo



Salla plenare e Parlamentit Estonez

madje bëri që qytetarët që merrin pjesë në këtë formun të jenë më përgjegjës dhe më praktik. Pos faktit që Kushtetuta i qëndroi sfidave të kohës, Asambleja vuri edhe themelet e një tradite të re të zhvillimit të debatave mjaft intensive, duke respektuar kështu fatin tragjik të popullit dhe dëshirën për të hartuar një Kushtetutë të përshatshme për Estoninë.

Së këtejmi, shoqëria estoneze e ndiqte procesin e hartimit të Kushtetutës së re me një interes jashtëzakonisht të madh. Çështjet më akute

u diskutuan nëpër shumë artikuj dhe fjalime të ndryshme jashtë Asamblesë, që pa dyshim se patën ndikim tek anëtarët e Asamblesë. Ndërkaq, debati aktiv u mbështet përmes publikimit të drafteve të Kushtetutës në shtyp dhe duke bërë të mundur qasjen e gazetarëve në sesionet e Asamblesë. Diskutimet rreth kompetencave të Presidentit dhe procesit të zgjedhjes së Shefit të shtetit ishin mjaft interesante dhe intensive. Kjo për faktin se shumë anëtarë të Asamblesë kishin mendime të ndryshme për këto çështje nga publiku,

i cili mbështeste idenë që Presidenti të ketë më shumë pushtet dhe që të zgjidhej drejtpërsëdrejti nga vota e popullit. Një shqetësim tjetër që u ngrit në Asamble ishte edhe pasojat që mund të kishte për një demokraci të re dhe të brishtë konflikti midis dy institucioneve kryesore të vendit si Presidenti dhe Parlamenti. Prandaj, ne e kuptuam se rruga më lehtë mbase nuk është edhe rruga më e mirë për hartimin e Kushtetutës.

Duke u mbështetur në përvojën e Estonisë, mund

të them se Kushtetuta jo vetëm që është bazamenti i sistemit juridik, por është udhërrëfyese i së ardhmes. Në thelb, Kushtetuta është një marrëveshje qytetare, e cila krijon parakushte për një bashkëpunim konstruktiv midis grupeve të ndryshme të shoqërisë për një të ardhme të përbashkët. Së këndejmi, është shumë me rëndësi që hartimi i Kushtetutës të bëhet përmes një procesi të hapur dhe gjithëpërfshirës. Në seminarin e organizuar në Prishtinë pata kënaqësinë të shoh se sa shumë i kushtojnë rëndësi deputetët e Kuvendit të Kosovës kësaj çështje.

Ndërsa po shetisja nëpër Prishtinë krijova përshtypjen se ky vend ishte i etur për komunikim me botën e jashtme. Këtë përshtypje e krijova nga shumë antena nëpër çatitë e shtëpive, por edhe për arsye se gjatë bisedave të shkurtëra që pata me njerëzit nëpër rrugë ishte më se e qartë sa me sa padurim e prisnin ata statusin e Kosovës, ndërsa dëgjonin lajme të shumta nga bota. Së këndejmi, unë e pata të qartë, si asnjëherë më parë, se çfarë përgjegjësie mbanin në lidhur me zgjidhjen e statusit. Kosova ka nevojë jo vetëm për qartësi të statusit, por edhe për Kushtetutën e saj - qoftë edhe për fëmijët e saj, që më rastisi t'i shoh në fotografi.



Procesi kushtetues dhe roli i kuvendit

Themeli mbi të cilin do të funksionojë shteti demokratik i Kosovës është Kushtetuta e Kosovës. Prandaj, procesi i përgatitjes, hartimit dhe miratimit është prioritet. Procesi i hartimit është i rëndësishëm dhe duhet të përbëjë katër elemente kryesore:

1) të jetë gjithëpërfshirës, të involvojë sa më shumë qytetarë të Kosovës para dhe gjatë finalizimit të tekstit, përmes fushatave të edukimit dhe mediatike, forumeve, tryezave të rrumbullakëta, vërejtjeve individuale etj. Kjo siguron legjitimitetin e rregullit kushtetues;

2) të jetë transparent duke formuar kanalim e komunikimit në mes të hartuesve dhe qytetarëve;

3) të ketë kohë të mjaftueshme

për ndërtimin e koncensusit politik dhe pajtueshmërisë së gjërë për çështjet e ndieshme kushtetuese siç janë çështjet e minoriteteve;

4) të sigurojë “pronësinë kosovare” në mënyrë që të jetë e qëndrueshme dhe me ndikim afatgjatë.

Nga fakti se Kushtetuta është shprehje e “vullnetit të popullit” dëse ajo buron drejtpërsëdrejti prej tij. Prandaj, përgjegjës për hartimin është Kuvendi i Kosovës. Kjo përgjegjësi kërkon punë serioze dhe krijimin e një trupi të veçantë të Kuvendit, Këshilli Kushtetues. Ai mund të përbëhet nga vendimarrësit politikë, ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, deputetët e tjerë. Nga të gjitha sa u tha më lartë rrjedhë se procesi i hartimit të Kushtetutës është po aq i rëndësishëm sa edhe përmbajtja e saj.

*Gjylnaze Syla
Kryesuese e grupit
parlamentar të AAK-së*

Kushtetuta – Ndermarrje e perbashket madhore

Kushtetuta është padyshim njëra nga ndërmarrjet më të rëndësishme por edhe më të vështira të procesit të përgjithshëm të shtetformimit. Kushtetuta është kurorëzim e materializim i përpjekjeve të deritashme dhe bazament i sundimit ligjor në Kosovën e Re të lirë, demokratike, pluraliste e evropiane.

Si e tillë, ndërmarrja kushtetutebërëse është dhe do të duhej kuptuar dhe trajtuar si interes, sfidë dhe obligim të të gjitha segmenteve institucionale ,shoqërore e profesionale të Kosovës. Dhe jo vetëm kaq, por Kushtetuta e ardhshme e Kosovës, do të jetë edhe pasqyrë e sublimuar e rezultateve të të gjithë misionit tashmë të dëshmuar si mision i suksesshëm por edhe i kushtueshëm paqekrijues dhe paqeruajtës i Bashkësisë Ndërkombëtare dhe si e tillë , kushtetua e ardhshme do të ketë edhe mbështetjen dhe përkrahje e nevojshme politike e profesionale ndërkombëtare, mbështetje dhe përkrahje që edhe deri tash .

Procesi kushtetutebërës për Kosovën e re do të jetë prandaj sublimim, sintetizim dhe finalizim i përbashkët i një procesi dhe projekti të përbashkët kosovar e ndërkombëtar. Një proces sui generis kushtetutebërës si fazë finale e një procesi po ashtu sui generis shtetformues.

Si I tillë procesi i kushtetutebërjes nuk i duron interesat e motivet e ngushta meskine e partikulariste, çfarëdo qofshin ato dhe nuk mund të bëhet e të mbahet peng i tyre . Kushtetuta nuk mund dhe nuk bën të mos jetë proces madhor , gjithëpërfshirës dhe i hapur për të gjitha komunitetet, për të gjitha forcat politike, për të gjitha institucionet shtetërore dhe segmentet e shoqërisë civile, për rrethet akademike e shkencore dhe për të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë që duan, dinë dhe mund të kontribuojnë. Besoj dhe nuk mund të mos besoj se kështu edhe do të ndodhë dhe në këtë mënyrë bashkërisht do t’i sigurohet një kushtetutë cilësore dhe moderne themeluese e shtetit të ri, modern e demokratik të Kosovës.

*Hydajet Hyseni
Anëtar i Kuvendit të Kosovës*



Ligji për trashëgiminë kulturore

Dragisha Krstoviq / deputet i Kuvendit të Kosovës nga Grupi parlamentar i LSKM

Ligji për trashëgiminë kulturore, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në seancën e mbajtur me 9 tetor 2006, nuk i siguron parakushtet dhe mekanizmat e nevojshëm për mbrojtjen efikase të trashëgimisë kulturore të Kosovës nga shkatërrimi eventuale, që është qëllimi kryesor i tij. Ligji merret kryesisht me përsëkrime dhe përmban shumë pak rregulla, përmes të cilave bëhet përcaktimi i detyrave dhe obligimeve të subjekteve, të cilat merren me trashëgiminë kulturore. Ndaj, kihet përshtypja se ky ligj lë shumë për të dëshiruar. Kjo mund të shkaktojë shumë probleme lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Pos këtyre, mjaft dispozita të ligjit të miratuar janë diskutabile jo vetëm sipas konventave ndërkombëtare, të cilat e rregullojnë këtë fushë, por edhe sipas Kornizës

Kushtuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë. Kështu fjala vjen nuk është krejtësisht e qartë se cilat institucione janë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji. Po kështu, kontestues është edhe çmimi i tregut për një objekt të trashëgimisë kulturore. Kjo lidhet me nenin 4. 21 dhe 4. 22 të këtij ligji, si dhe me dispozitat e nenit 11 të ligjit, të cilat e rregullojnë jo vetëm çështjen e sanksioneve, por edhe të kompetencave të Kuvendit të Kosovës për të përcaktuar lartësinë e pagesës së gjobave.



Për më tepër, sipas rregullore, neni 11.2 mund të konsiderohet krejtësisht i panevojshëm.

Së këndejmi, shtrohet pyetja se a do ta arrijë qëllimin, të cilin do të duhej ta kishte ky ligj, në formën dhe mënyrën si është miratuar, apo a do të jetë në gjendje ta mbrojë trashëgiminë kulturore në mënyrë të qartë, adekuate dhe efikase. Sipas mendimit tim, hartimi i ligjeve vetëm sa për të thënë se i kemi ligjet dhe e kemi mbuluar apo rregulluar me ligj një fushë të caktuar jo

vetëm që nuk është praktikë e mirë, por madje një praktikë e këfillë mund të jetë edhe e rrezikshme. Ndaj, lipset që të gjitha ligjet, e sidomos ligji në fjalë, të hartohet asisoj që të sigurojë mbrojtje maksimale, të jetë i qartë për të gjithë ata që e lexojnë dhe që të përjashtojë dhe shmangë çdo boshllëk dhe mundësi ligjore për interpretime të ndryshme dhe keqpërdorime të vetë ligjit apo të objekteve, të cilat ligji mëton t'i mbrojë.

Me kalimin e kohës do të shihet nëse ligji për trashëgiminë kulturore do të nënshkruhet nga PSSP-ja në formën e tanishme, apo mbase ai do të kërkojë që ky ligj të ndryshohet dhe plotësohet. Mirëpo, derisa ky ligj kaq i rëndësishëm të mos finalizohet, një pjese të mirë të trashëgimisë kulturore të Kosovës ende i kanoset rreziku nga shkatërrimi i mëtejshëm.

Ligji mbi lirinë e fesë: hapat e ardhshëm

Alfons B. Lentze / Konsulent i projektit të financuar nga KE 'Përkrahja për Kuvendin e Kosovës'

UNMIK-u ka amandamentuar ligjin për fenë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 korrik, për t'i specifikuar me emër pesë bashkësitë fetare dhe e ka shpallur ligjin më 24 gusht, ndonëse UNMIK-u nuk ka njoftuar publikisht shpalljen deri më 20 shtator. Amandamentimi i nenit 5.4 nuk i shton ose kufizon të drejtat e bashkësive të tjera fetare që nuk janë përmendur, pasi që aty thuhet 'përfshirë' gjë që gjithashtu implikon edhe bashkësitë tjera.

Ligji nuk përcakton se sa dhe cilat bashkësi fetare do të jenë në gjendje ta përfitojnë statusin ligjor, pasi që kjo çështje fillimisht nuk është kërkuar nga ana e bashkësisë ndërkombëtare.

Ligji e kishte afatin e fundit për t'u miratuar deri në fund të tetorit 2006. Ligji është një nga 13 ligjet prioritare për plotësimin e standardeve për të drejtat e njeriut të përcaktuara nga bashkësia ndërkombëtare e cila

aktualisht është duke qeverisur me Kosovën – ligji është redukuar me qëllim të eliminimit të çfarëdo reference për regjistrimin e bashkësive fetare. Ai mbulon parimet e përgjithshme për liritë fetare.

Është thënë se qeveria përmes ministrisë relevante do të hartojë rregulla me të cilat do ta drejtojë statusin ligjor në kohë të duhur. Statusi ligjor i bashkësive fetare do të jetë një çështje shumë e vështirë.

Kjo do të varet nga organet legjislativë dhe ekzekutive, dhe – sipas të gjitha gjasave – nuk do të shqyrtohet deri pas zgjidhjes së statusit final të Kosovës. Por kjo do të duhet të monitorohet nga afër prej palëve të ndryshme të interesuara, vendore dhe ndërkombëtare.

Shembuj të çështjeve të cilat duhen monitoruar janë: tatimimi i bashkësive fetare, të drejtat sipas kushtetutës së ardhshme të Kosovës, etj.

Rëndësia e zbatimit të ligjit mbi gjuhët

Mahir Jagxhillar, 6+ / Anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës



Është e padiskutueshme që Kosova po hyn në një fazë kritike të historisë së saj. Vendimi për statusin final dhe procesi i shtet-ndërtimit do të kërkojnë shumë sakrificë të mëdha dhe kompromise nga të gjithë qytetarët e Kosovës. Të gjitha shtetet kalojnë nëpër situata dhe faza të vështira gjatë historisë së tyre, që zakonisht përfundojnë jo vetëm me përcaktimin e kufijve dhe institucioneve, por edhe të identitetit të tyre si shtete të veçanta në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare. S'do mend se në këtë kuadër vendimi për gjuhën apo i gjuhët zyrtare të shtetit është njëri ndër vendimet më të rëndësishëm në përcaktimin e identitetit të shtetit.

Pas një sërë diskutimesh, debatesh, raundesh votimi dhe kompromisesh, Kuvendi i Kosovës më në fund miratoi Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit. Duke votuar kësaj Kuvendi

jo vetëm që e ka hapur rrugën për zbatimin e njërit nga ligjet më të rëndësishëm në Kosovë, por njëherësh shpresojmë se miratimi i këtij ligji do të ndikojë edhe në vlerësimin pozitiv të zbatimit të standardeve për Kosovën. Ndaj është me rëndësi që të identifikohen mangësitë dhe lëshimet e bëra gjatë hartimit dhe miratimit të ligjit me qëllim që të evitohet përsëritja e tyre gjatë zbatimit të tij.

Ishte gabim që në fillim të procedohet me hartimin e ligjit pa një analizë adekuate jo vetëm të historisë së gjuhëve në Kosovë, por edhe të legjislacionit të mëparshëm dhe atij aktual për përdorimin e gjuhëve. Madje as Kuvendi nuk kishte bërë hulumtime për mekanizmat e mirëfilltë dhe të qëndrueshëm për përcaktimin dhe përdorimin e gjuhëve. Për më tepër, ata e filluan diskutimin në Kuvend para se të vendosej një nivel i duhur bashkëpunimi midis grupeve parlamentare, Zyrës së Kryeministrit dhe aktorëve të tjerë relevantë për t'i tejkaluar ambiguitetet në ligj.

Gabimi i dytë politik ishte ndër lidhja e gjuhëve të grupeve të ndryshme minoritare me përqindjen e popullatës që e flasin atë. Nisur nga fakti se ende mungojnë të dhënat për regjistrimin e popullsisë dhe udhëzimet për decentralizimin në Kosovë, që ende nuk janë përcaktuar si duhet dhe janë të paplota, këto përqindje duket se janë të pakuptimta. Megjithatë, pas përfshirjes

së rekomandimeve të OSBE-së dhe të palëve të tjera dhe miratimit të disa amandamentave, ligji tani ka marrë formën me të cilën të gjitha palët e interesuara janë të kënaqura.

Duke mbajtur parasysh atë që u tha më sipër, duhet të bëhet vazhdimisht monitorimi dhe vlerësimi i ligjit me qëllim që të sigurohet garantimi i plotë i përdorimit të gjitha gjuhëve në praktikë. Pos kësaj, gjatë monitorimit dhe zbatimit të ligjit duhet të identifikohen të gjitha problemet dhe mangësitë e tij me qëllim që të bëhen ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme dhe të tejkalohen këto lëshime me kohë. Mirëpo, sfida më e madhe për zbatimin e suksesshëm të këtij ligji sipas të gjitha gjasave do të jetë Buxheti i Kosovës, sidomos kur është fjala për përcaktimin e gjuhëve zyrtare nëpër komuna dhe ushtrimin e të drejtës së përdorimit të gjuhës serbe. Prandaj, shuma që caktohet për zbatimin e ligjit dhe burimet nga caktohen këto fonde mund të ketë ndikim shumë të madh në përdorimin e të gjitha gjuhëve zyrtare.

Veç kësaj, një sfidë tjetër do të jetë përcaktimi i popullatës prej 3 deri në 5 % dhe përcaktimi i gjuhëve që e kenë gëzuar të drejtën e përdorimit tradicionalisht. Në mungesë të dhënave nga regjistrimi, do të jetë tejet e vështirë për të konstatuar se kush, dhe me çfarë kriteresh, do të jetë në gjendje të përcaktojë të drejtat për përdorimin e gjuhëve në komuna të caktuara. Veç kësaj, mbetet

për t'u parë se si dhe kush do ta bëjë harmonizimin e statuteve të komunave, Kornizës Kushtetuese, Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, meqë ligji kërkon në mënyrë eksplicite që ky harmonizim të bëhet gjatë 6 muajve të ardhshëm.

Një objektivi tjetër me rëndësi për ligjin është që të ndihmojë dhe lehtësojë përdorimin zyrtar të gjuhëve në nivelin komunal, siç është fjala vjen përdorimi i gjuhës turke në komunën e Prizrenit. Por, është madje edhe më me rëndësi që të bëhet identifikimi dhe përcaktimi i gjuhëve zyrtare në komuna të tjera me komunitete më të vogla minoritare. Në rastin konkret e kemi fjalën për përdorimin e gjuhës turke si gjuhë që është përdorur tradicionalisht në komunën e Mitrovicës, Prishtinës, Vushtrrisë dhe Gjilanit. Duke mbajtur parasysh statusin e saj zyrtar në të shkuarën si dhe përdorimin e saj tradicional nëpër gjithë Kosovën, kjo nuk do të duhej të ishte problem.

Nëse vërtetë duam ta ruajmë identitetin shumë-gjuhësor dhe shumë-etnik të Kosovës, atëherë këtë më së miri mund ta dëshmojmë përmes zbatimit të mirëfilltë dhe të përpiktë të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve. Ndërkaq, nëse gjatë zbatimit të ligjit vërehen mangësi në dispozitat e tij, atëherë s'do mend se do të ketë nevojë për ndryshime dhe plotësime të ligjit.

Zbatimi i ligjeve në mënyrë serioze

Michael Schutz / Wolff-Michael Mors / Misioni i OSBE-së në Kosovë

Ligji duhet të pasqyroj qartë vendimin e marrë politik dhe të paraqet strukturën e temës së tij. Në masë shumë të vogël ai duhet të ofroj strukturë të plotë. Hollësia më thelbësore e funksionit të tij shpeshherë paraqitet në akte të ndryshme të natyrës mjaft teknike nga dega ekzekutive. Këto udhëzime administrative i përkasin legjislacionit të rangut dytësor të kornizës së vendimit të marrë nga parlamenti. Zbatimi në kuptimin origjinal të tij do të thotë “plotësim”, prandaj me një udhëzim administrativ, zbraztirat e lëna nga Kuvendi plotësohen me legjislacion dytësor nga organi përgjegjës ekzekutiv. Përmes legjislacionit dytësor, ligji bëhet instrument i realizueshëm dhe aplikueshëm, nëse palët përkatëse i plotësojnë obligimet e tyre të parapara me ligj, që do të thotë, nëse ata e marrin ligjin seriozisht.

Tanimë kur është ndërmarrë nisma për rregullimin e një çështjeje të caktuar me ligj, nevojitet të bëhen vlerësime të caktuara për sa i përket hartimit të ligjit si dhe zbatimin e aplikimin e tij që t’i udhëzojnë të dyja palët, ata të cilët i hartojnë dhe miratojnë këto ligje. Tashmë në fazën e hartimit të legjislacionit parësor, i cili bëhet rregullisht nga dega ekzekutive, duhet të vlerësohen resurset e nevojshme për zbatim (gjithashtu edhe aplikimi) në mënyrë që të mbështetet serioziteti i ligjit. Moszbatimi i ligjeve e pengon rëndë përgjegjësinë e parlamentit dhe e vështirëson



zbatimin e vullnetit politik. Për shembull është e patolerueshme që të dy ligjet, të cilat janë nxjerrë në vitin 2003 nuk janë zbatuar fare.

Duke e pasur parasysh dinamikën, që nxjerrja e legjislacionit dytësor është zakonisht e nevojshme për ta lehtësuar

zbatimin, OSBE-ja e ka vlerësuar për të tretën herë statusin e zbatimit të ligjeve në Kosovë, dhe i ka përpiluar rezultatet në një raport për t’i botuar. Si edhe në dy raportet e fundit, synim parësor është të vërtetohet që deri në çfarë mase janë duke u zbatuar si duhet ligjet e miratuara nga Kuvendi



i Kosovës. Theksi bie në ligjet e shpallura në vitin 2005, por kjo përfshin vazhdimin prej viteve të mëparshme. Në ndërlidhje me këtë, zbatimi nënkupton përfshirjen e hartimit të legjislacionit dytësor si dhe vendosjen e organeve siç kërkohet me ligj. Zbatimi i ligjit në raste konkrete nuk mbulohet nga fushëveprimi i raportit. Pasi që OSBE-ja është duke i vendosur çështjet parësore të misionit – gjithashtu duke e pasur parasysh të ardhmen e prezencës ndërkombëtare në Kosovë – raporti i tanishëm do të jetë ai i fundit për temën e tanishme. Kjo nuk duhet në asnjë mënyrë të dobëson zbatimin e ligjeve dhe mbikqyrjen e tij. Kjo çështje është e një rëndësie të madhe dhe do të vazhdoj të jetë edhe në të ardhmen.

Por kush është përgjegjës për zbatimin e ligjeve? A është Zyra e Kryeministrit (ZKM), Ministritë, Kuvendi i Kosovës? Në fakt çdonjëra nga këto janë pjesërisht të përgjegjshme.

Pamarrëparasysh faktin që është vështirë të bëhet një vlerësim i statusit të zbatimit të të gjitha ligjeve me disa fjalë, për shkak të kësaj ndërlidhëshmërie mund të nxirren disa konkluzione. Sa i përket ministrive, vlerësohet të jetë bërë një përparim i konsiderueshëm, ndonëse akoma mbetethapsirëpërpërmirësim. Për sa i përket ZKM-së, OSBE-ja fatkeqësisht ka bërë një vlerësim të punëve thelbësore të mbetura prapa lidhur me obligimet për zbatimin e tyre. Nevoja për përmirësim është

e qartë dhe urgjente. Do të jetë e vështirë për ZKM-në që ta merr rolin kryesor në koordinim dhe procesin e hartimit, siç kërkohet sipas rregullave të qeverisë, nëse ata nuk janë në gjendje t'i zbatojnë ligjet atëherë janë përgjegjës për procesin e zbatimit. Duke e pasur parasysh domosdoshmërinë për përmirësim, shihet e nevojshme të dedikohet së paku një person me përgjegjësi t'i siguroj brenda qeverisë ligjet përkatëse të zbatohen me kohë. Ekziston ende një mosbalancë e dukshme ndërmjet hartimit të legjislacionit parësor dhe zbatimit të këtyre ligjeve, duke e hartuar legjislacionin dytësor.

Kuvendi i Kosovës ka marrë përsipër një obligim mjaft të madh për të mbikqyrur zbatimin e ligjeve. Rregulla 53 e Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës (ReP) i drejtohet kësaj çështjeje dhe ia jep pushtetin këshillave përkatës të rradhës. Ndonëse, duket që paragrafi i parë i rregullës 53 e përcakton funksionin e mbikqyrjes si 'e drejtë' e komisionit, paragrafi tre jep 'obligime' mjaft të hollësishtme për komisionin përkatës. Kjo përfshin, ndër të tjera hulumtimin dhe kontrollimin e kompetencave si dhe obligimet e ndryshme për raportim.

Këta mekanizma ofrojnë opzione të mira për mbikqyrje parlamentare, mjaft teknike dhe gjithëpërfshirëse mbi aktivitetet hartuese të degës ekzekutive, por ato nuk janë duke u shfrytëzuar në masën e mundshme dhe të duhur. Megjithatë, një hulumtim i hapur i kësaj çështjeje gjithashtu bënë të parashtrihet pyetja se nëse Kuvendi i Kosovës ka resurse të mjaftueshme për zbatimin e

rregullës 53 në tërësi. Është e vërtetë që këshillat pa staf ndihmës janë përgjegjës për përpilimin e shqyrtimit gjithëpërfshirës mbi zbatimin e çdo ligji? Nëse jo, atëherë duhet të ndryshohet ReP; përndryshe ligjet nuk do të mirren me seriozitet.

Pavarësisht prej asaj, nëse këshillat kanë resurse për t'iu përmbajtur rregullës 53, është në interes publik të sigurohet që qeveria është duke i përmbushur obligimet e saja për procesin e zbatimit. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale së bashku me NDI, kohëve të fundit i janë drejtuar kësaj teme me një raport të veçantë për zbatimin e ligjit në shëndetësi. Puna e tyre mund të vlerësohet si një shembull i avancuar lidhur me mbikqyrjen parlamentare në këtë fushë të caktuar.

Me pak fjalë, hartuesit e legjislacionit parësor, zakonisht dega ekzekutive duhet t'i vlerësoj me kujdes resurset e nevojshme për ta vënë ligjin në praktikë. Kjo nuk duhet të jetë aq e komplikuar, në fund të fundit, zbatimi në përgjithësi kryhet nga e njëjta ministri, e cila e ka hartuar projekt ligjin. Kuvendi i Kosovës, gjithashtu duhet ta marrë parasysh se sa real dhe i mundshëm është projektligji për tu zbatuar, para se ai të miratohet dhe duhet të vazhdoj me realizimin e përgjegjësisë të kaluara tek dega ekzekutive. Raporti i tretë mbi zbatimin e ligjeve të Kuvendit të Kosovës do t'i drejtohet kësaj çështjeje në mënyrë më gjithëpërfshirëse. Porosia thelbësore e këtij raporti, që vlen për të gjitha institucionet dhe çdonjërin është: ligjet duhet të merren seriozisht.

Shkalla e implementimit

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, ORA

Sektori shëndetësor paraqet një prej fushave me rëndësi jetike për çdo shoqëri. Kosova, duke qenë në fazën e tranzicionit shumëdimensional, po ballafaqohet me vështirësi të theksuara në përpjekjet e saj për të vendosur një sistem shëndetësor i cili do të përmbushë nevojat e qytetarëve të saj.

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale (Komisioni) është i shqetësuar për gjendjen e rëndë të shëndetësisë kosovare dhe si pjesë të mandatit të tij ka interesimin që të kontribuojë në përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Meqenëse qëllimi kryesor i Ligjit është vënia e bazës ligjore për rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore me pikësynimin kujdesin e shëndetit të qytetarëve të Kosovës, mendoj se është e domosdoshme që edhe Qeveria, konkretisht Ministria e Shëndetësisë, por edhe Parlamenti, të bëjnë monitorimin e zbatimit të këtij Ligji, si dhe ligjeve tjera në përgjithësi.

Aktiviteti mbikëqyrës i komisioneve parlamentare paraqet praktikë relativisht të re që po zhvillohet në Kuvendin e Kosovës, sidomos sa i përket monitorimit të zbatimit të ligjeve që janë miratuar nga Kuvendi. Komisioni ka ndërmarrë këtë aktivitet në funksion të përmbushjes së mandatit të cilin ia jep Rregullorja e Punës së Kuvendit, me motivin kryesor që të sigurohet realizimi i qëllimeve

të ligjvënësve në masën dhe efektivitetin e paramenduar kur Ligji për Shëndetësi është miratuar. Së këndejmi, Komisioni nuk është udhëhequr nga dëshira për të gjetur të meta në punën e Ministrisë apo të institucioneve tjera, por nga dëshira për të siguruar kujdes sa më cilësor shëndetësor për të gjithë qytetarët e Kosovës, që një herit paraqet edhe një prej qëllimeve kryesore të cilat mundohet të realizohen me anë të zbatimit të këtij Ligji.

Ligji për Shëndetësi është ligj bazik për shëndetësinë dhe kjo ka qenë njëra prej arsyeve që e ka nxitur Komisionin për të monitoruar pikërisht zbatimin e këtij Ligji. Arsye tjetër ka qenë gjendja jo e kënaqshme në shëndetësinë kosovare që vazhdon të jetë e njëjtë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji. Në radhë të parë janë për brengosje: rënia e besimit të qytetarëve në sistemin publik të shëndetësisë, pakënaqësia e punëtorëve shëndetësorë, rënia e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor në Kosovë dhe mungesa e avancimit të kujdesit shëndetësor, veçanërisht në nivelin tretësorë.

Si rezultat të punës disamujore, Komisioni ka përgatitur Raportin i cili shprehë vlerësimin e tij për gjendjen lidhur me zbatimin e Ligjit për Shëndetësi duke përfshirë edhe disa rekomandime për masat që duhet të ndërmerren. Ky Raport i është dorëzuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për debat dhe miratim në Kuvend. Pas miratimit

dhe jetësimin të ligjit për shëndetësi

Kryetare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale



Komisioni për shëndetësi gjatë vizitës në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK)

nga Kuvendi, Raporti do t'i adresohet Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Shëndetësisë.

Komisioni ka rekomanduar gjithashtu që ky Raport të jetë publik dhe të vendoset në vebfaqen zyrtare të Kuvendit.

Synim i këtij monitorimi ishte verifikimi i zbatimit dhe aplikueshmërisë së Ligjit me qëllim të përmirësimit të gjendjes në fushën e Shëndetësisë.

Objektivat kryesore të këtij monitorimi ishin:

- Vlerësimi i përgjithshëm mbi zbatimin e Ligjit për Shëndetësi.

- Vlerësimi i shkallës së përbushjes së obligimeve specifike nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë në procesin e zbatimit të Ligjit.

- Vlerësimi mbi nxjerrjen e akteve nënligjore dhe koordinimit në mes të Ministrisë dhe institucioneve tjera shëndetësore.

- Vlerësimi i efekteve dhe pasojave të moszbatimit efektiv të Ligjit për Shëndetësi.

Me qëllim të realizimit të këtyre synimeve dhe objektivave, Komisioni ka ndërmarrë hapat në vijim:

1. Formimi i Grupit Punues nga anëtarët e Komisionit;

2. Identifikimi i institucioneve, autoriteteve dhe subjekteve në shoqërinë civile, relevante për zbatimin e Ligjit për Shëndetësi;

3. Vizita në institucionet shëndetësore dhe institucionet relevante qeveritare në nivelin lokal dhe qendror;

4. Bisedat e drejtpërdrejta me shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore;

5. Studimi dhe analiza e dokumentacionit relevant.

Mbledhja e informacioneve të nevojshme nga ana e Komisionit është zhvilluar në dy faza:

- Mbledhja e fakteve nga burimet jo ministrore (institucionet lokale të qeverisjes, shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore, organizatat relevante jo-qeveritare dhe aktorët e tjerë).

- Mbledhja e informacioneve nga Ministria e Shëndetësisë përmes dëgjimeve..

Me këtë Komisioni ka përmblyllur mbledhjen e informacioneve nga aktorët relevantë.

Pas përfundimit të mbledhjes së informacioneve është bërë analiza e të dhënave të fituara, diskutimi dhe nxjerrja e përfundimeve. Në Raport janë sintetizuar të gjitha informacionet relevante të mbledhura gjatë një periudhe disamujore.

Rezultatet e monitorimit paraqesin konstatimet e Komisionit lidhur me zbatimin e Ligjit. Konstatimet bazohen në fakte dhe argumente të qëndrueshme dhe jo në mendime subjektive.

Në bazë të fakteve relevante të cilat kanë rrjedhur nga puna e Komisionit, komisioni në bazë të përfundimit të vet ka përpiluar rekomandimet, të cilat presim që do të miratohen edhe në seancë plenare nga deputetet tjerë. Në gjithashtu presim që pas një afati kohor, Ministri do të raportojë në Kuvend lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Parlamenti dhe media:

Çfarë duhet të jetë raporti ndërmjet parlamentit dhe medieve?

Skënder Durmishi



Kjo është pyetje e shtruar shpesh, e diskutuar gjatë. Madje, vazhdon të jetë ende temë që trajtohet dhe, duke qenë relativisht e ndjeshme si temë, nuk është edhe aq e lehtë. Sa i duhen dhe sa e pengojnë njëra-tjetrën? Kur e pengojnë dhe kur e ndihmojnë njëra-tjetrën? Cila është një vijë e kuqe e cila nuk duhet kaluar në komunikimet ndërmjet tyre? Cili është demarkacioni ndërmjet interesit publik që duhet të gjurmohet e të prezantohet nga media (pra deri ku mund të shkohet në bazë të të drejtës së ligjshme për të ditur diçka) dhe ku fillon ajo pjesë e jetës private të një figure publike, ose pjesa që quhet sekret zyrtar, që nuk duhet të jetë e prekur nga media etj., etj.

Këto pyetje janë trajtuar e trajtohen dhe, në vende të ndryshme, varësisht nga emancipimi demokratik ose specifikat e tjera, përgjigjet janë dhënë në mënyra të ndryshme. Dallimet kryesore megjithatë janë në praktikën e trajtimit, ndërkohë që në aspektet formale, juridike e deklarative, qëndrimet janë më të unifikuara dhe kryesisht afirmative.

Është e qartë se kjo temë është shumë delikate dhe sensitive: sapo të shtrohet si temë reagimi i parë, impulsi i parë, është se kjo gjë dihet – media duhet të ketë pavarësi absolute dhe institucionet shtetërore duhet të mbajnë sa më larg duart nga media. Kjo, në kuptimin teknik dhe formal-juridik, është e vërtetë dhe duhet të jetë e garantuar. Kjo edhe është e garantuar me një mori aktesh ndërkombëtare duke filluar nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, pastaj Konventa Evropiane për të Drejtat e

Njeriut, me akte të veçanta etj., etj. Por, përtej kësaj të vërtete nuk ka pse të përjashtohet mundësia që të ketë edhe një lloj partneriteti ndërmjet medieve dhe Parlamentit. Është fjala më shumë për një “modus operendi” që nuk e rrezikon funksionin themelor, por përkundrazi e ndihmon atë. Një lloj “marrëveshje xhentëlmene”, pa paragjykime, e cila motivohet pikërisht nga pyetja se çfarë lloj komunikimi ndërmjet medieve dhe Parlamentit është më së shumti në interesin e qytetarëve.

Kuvendi i Kosovës tashmë e ka bërë të qartë se është i përcaktuar për variantin e partneritetit me media. Në tërë veprimtarinë, puna e Kuvendit është maksimalisht publike. Kuvendi i Kosovës i ka shtruar vetes dhe po realizon një cikël reformash, që përbëjnë ndryshime esenciale në punën e Kuvendit. Një nga pikat e rëndësishme të kësaj qasjeje të re është pikërisht raporti i veçantë i bashkëpunimit me media.

Në një pritje të organizuar me përfaqësuesit e të gjitha medi-



a është i mundshëm partneriteti?

A janë rivalë me mosbesim të përhershëm, apo mund të jenë ndoshta edhe partnerë?

Këshilltar i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës

eve, kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kolë Berisha, ka shpjeguar qëllimet:

“Ne kemi dëshirë që qytetari t’i njohë sa më mirë ligjet tona. Kjo mund të arrihet edhe me ndihmën e medias. Pra, ju ftojmë që të jeni edhe më afër punës dhe aktiviteteve të Parlamentit. Veproni sipas rregullave dhe dyert (dhe dokumentet) e Kuvendit të Kosovës janë të hapura për ju. Në Parlament nuk ka sekrete. Çdo gjë mund të dihet, çdo gjë duhet të dihet – sepse është Parlament”.

Ky është orientim i motivuar nga bindja së në këtë mënyrë mundësohet realizimi i parimeve themelore të parlamentarizmit – transparencja, efikasiteti, përgjegjshmëria, përfshirja sa më e gjerë e faktorëve dhe zërave të ndryshëm të shoqërisë në punën e Kuvendit.

Pra, duhet vërejtur se mediet ftohen, nuk refuzohen. Të jenë sa më shumë në Kuvend, për të raportuar gjerësisht, tërësinë e punës, edhe të mirat edhe të këqijat, sukseset dhe mossukseset. Media të

zgjedh atë që e vlerëson më kryesore, por të jetë në Parlament, ky është interes i përgjithshëm.

Preferenca për partneritet ka gjithnjë më shumë ithtarë nëpër botë kur bëhet fjalë për kërkim të efikasitetit në performansën e punës së Kuvendit dhe të medieve. Ky është konkluzion edhe i disa tubimeve dhe forumeve ndërkombëtare të mbajtura në këtë temë.

Në këto forume ka dominuar bindja dhe praktika se partneriteti

është i mirëseardhur – si interes jo i Parlamentit, jo i medias, por para së gjithash si interes i qytetarit. Është i kuptueshëm mosbesimi, por jo trajtimi armiqësor i njëri-tjetrit. Media, duke qenë në borxh ndaj lexuesit, shikuesit e dëgjuesit të vet, duhet ta bëjë pjesën e vet të punës që Parlamenti të ndiqet me syrin e publikut, ta bëjë që të ketë përqendrim të vëmendjes së opinionit. Ndërsa, Kuvendi i garanton medias punën e pavarur kritike e profesionale, duke ofruar çdo lloj informate relevante. Kur të respektohen këto kritere – partneriteti është i mundshëm, madje edhe i dobishëm.



Media ka të drejtën themelore për të qenë e informuar. Parlamenti është institucioni demokratik legjislativ dhe vendimmarrës më i afërt me qytetarin. Që të dyja i kanë normuar qartë funksionet dhe garancitë për pavarësinë në punën e tyre. E, megjithatë, mund të bashkëpunojnë.

Por, çështja është që kjo të mos shikohet si një detyrim, sepse detyrimi edhe shmanget sa herë që të jetë e mundur të bëhet kjo gjë, por të kuptohet si shans, pra si partneritet. Të perceptohet si një relacion në të cilin të dyja kanë nevojë për njëra-tjetrën, plotësojnë njëra-tjetrën. Dhe, kur thuhet se kanë nevojë, nuk ka fare pse të mendohet në censurë, nga njëra palë, dhe në servilizëm ose shmangitje të pavarësisë editoriale, nga pala tjetër. Emëruesi i përbashkët edhe për Kuvendin edhe për medien është qytetari dhe e drejta e tij për të qenë i informuar. Kjo mund të bëhet më mirë dhe më lehtë e më shpejt me partneritet.



Agjensioni Kosovar i Antikorrupsionit

Hasan Preteni, Drejtor i Agjensionit Kosovar të Antikorrupsionit

Agjensioni Kosovar i Antikorrupsionit, në vazhdim të tekstit AKA është organ i pavarur i cili ushtron përgjegjësitë e përcaktuara me "Ligjin kundër Korrupsionit" Nr. 2004/34.

AKA në Kosovë ka filluar punën më 17.07.2006 - me zgjedhjen e drejtorit. Aktivitetet primare të drejtorit janë të përcaktuara në Organogramin e Institucionit dhe në përcaktimin e rregullave procedurale të punës. AKA me ndihmën e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare do të jetë në funksion të plotë 6 muaj (pasi që të jetë zgjedhur Drejtori i AKA).

AKA është një institucion shumë i rëndësishëm i Kosovës. Veprimtaria e tij do të varet shumë nga përkrahja e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Brenga kryesore e të gjithë kosovarëve në aspektin politik, është statusi final i Kosovës, kurse në aspektin e "brendshëm" brengat kryesore janë papunësia dhe korrupsioni. Lufta kundër korrupsionit do të jetë argumenti kryesor para Komunitetit Ndërkombëtar se sa janë kosovarët të gatshëm të krijojnë shtet, të vetëdijëshohen, t'u bashkohen shteteve të qytetëruara të Evropës, të krijojnë institucione demokratike dhe të pavaruara. Idetë e drejtorit të AKA për veprim në afatin 5- vjeçar. Për të realizuar misionin e saj, AKA duhet të jetë:

- a) e pavarur
- b) profesionale
- c) me strukturë të profilizuar
- d) e hapur për bashkëpunim
- e) transparente
- f) mirë e paguar

a) E PAVARUR

Pavarësia nënkupton mosndikimin e spektrit politik në veprimin e saj, kuadri profesional duhet të jetë jashtë ndikimeve të partive politike, grupeve të interesit apo grupeve tjera joformale. Bartësit e aktiviteteve në AKA nuk duhet të jenë ata persona të cilët në biografinë e tyre mund të kenë njolla apo aktivitete kriminale. E kaluara e bartësve të aktiviteteve në AKA dhe e familjeve të tyre duhet të jetë dëshmi e

fortë të qytetari i Kosovës që të mund të mbështesë dhe përkrahë këtë Institucion. Objekti, në të cilin ushtron veprimin AKA, duhet të jetë i ndarë prej objekteve tjera të Qeverisë, prej Kuvendit apo ndonjë institucioni tjetër shtetëror. Ushtrimi i veprimtarisë në një objekt me institucionet tjera, paraqet rrezikshmëri të vazhdueshme për krijimin e raporteve në mes të të punësuarve, ku konflikti i interesave mund të paraqesë gjithmonë rrezik për mosbatueshmëri të ligjit.

b) PROFESIONALE

Bartësit e aktiviteteve në AKA duhet të jenë mirë të trajnuar, profesionalisht të përgaditur dhe të kenë njohuri profesionale për funksionalizimin e sistemit juridik në vend. Rëndësi të veçantë duhet t'i përkushtohet trajnimit të të rinjve, të cilët përgaditjen shkollore e kanë arritur edhe jashtë vendit. Njohja e gjuhëve të huaja (anglishtes në veçanti) njohja perfekte e kompjuterit, njohja e sistemit juridik dhe detyrat e veçanta në AKA, janë parametër i fortë për arritjen e suksesit. AKA duhet të përgadisë strategjinë e Kosovës kundër korrupsionit ose të amandemantojë egzistuesen. Njëherit duhet të propozojë ndryshime sistematike të sistemit juridik dhe, duke propozuar ndryshime, të ndikojë në zvoglimin apo pamundësinë e korrupsionit. AKA duhet të marrë pjesë (së bashku me organizatat dhe shoqatat tjera joqeveritare) në parandalimin e korrupsionit. AKA gjithashtu duhet të marrë pjesë dhe të këshillojë gjatë hartimit të platformës së kodit të etikës në sektorin publik dhe privat.

c) ME STRUKTURË TË PROFILIZUAR

Struktura e AKA duhet të mbulojë të gjitha sferat e veprimit. Struktura të përcaktohet në bazë të detyrave që i obligon ligji. Struktura nuk duhet kopjuar nga asnjë institucion tjetër, por duke i shfrytëzuar praktikatat e agjencioneve simotra në rajon, detyrat e përcaktuara me ligj dhe buxhetin e ofruar, të krijohet një strukturë funksionale. Shtrirja e AKA duhet të jetë horizontale dhe vertikale. Me shtrirje horizontale nënkuptojmë formimin e një qendre të fortë dhe stabile në nivel të Kosovës, kurse me shtrirjen vertikale nënkuptojmë funksionalizmin e qendrave nëpër regjionet e Kosovës-deri në nivel të komunave.

d) E HAPUR PËR BASHKËPUNIM

AKA duhet të bashkëpunojë me të gjitha strukturat vendore dhe ndërkombëtare të cilat për mision kanë luftën kundër korrupsionit, si dhe të shfrytëzohen të arriturat e shteteve të cilat kanë kaluar me sukses fazën e tranzicionit nga sistemet totalitare në atë demokratikë, të cilat kanë bartur titullarin e pronës nga ajo shoqërore e shtetërore në atë private. T'i shfrytëzojmë praktikatat e shteteve që u janë bashkangjitur apo janë në prag të bashkangjites së Bashkësisë Europiane. AKA duhet të bashkëpunojë edhe me institucionet edukative të vendit, të organizojë seminare dhe tryeza të ndryshme, me qëllim të edukimit të shtresave të gjera dhe që lufta kundër korrupsionit mund të luftohet vetëm me

angazhimin e të gjithëve. AKA duhet t'i paralajmërojë autoritetet e Kosovës për realizimin e detyrimeve që dalin nga aktet ndërkombëtare dhe t'u ofrojë rekomandime se si të përmbushen ato. Rëndësi të veçantë duhet t'i përkushtohet bashkëpunimit me institucionet gjyqësore dhe policore, të cilat veprat korruptive duhet t'i trajtojnë shpejt dhe saktë. Duhet menduar edhe për krijimin e organeve profesionale si në prokurori, ashtu edhe në gjyqësi, të cilat do të merren vetëm me luftën kundër korrupsionit.

e) TRANSPARENTE

Puna e AKA duhet të jetë transparente. Publikimi i veprimeve korruptive në institucionet e larta do të rriste besimin e qytetarëve të AKA dhe institucionet tjera. AKA duhet të hapë një "web" faqe dhe të sigurojë një lidhje të hapur telefonike,

ku qytetarët e Kosovës do të mund të raportojnë rastet korruptive.

f) MIRË E PAGUAR

Të punësuarit në AKA duhet të jenë mirë të paguar. Paga e tyre duhet të jetë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës - e mjaftueshme për sigurinë e mirqenjes së tyre dhe familjeve të tyre, si dhe të jetë stimulues për angazhimin e profesionistëve në të. Vetëm njerëzit e paguar mirë mund të jenë garant se nuk do të korruptohen dhe do të japin maksimumin në detyrat profesionale. Buxheti i Kosovës duhet të jetë garantues i mirë për veprimin e AKA edhe për dëmshpërblimin e atyre që luftojnë korrupsionin. Në luftë kundër korrupsionit nuk duhet kursyer mjetet financiare, sepse ato do të kthehen shumëfish. Personeli profesional duhet

të ketë tretman të veçantë edhe në prokurori dhe gjykata

PËRFUNDIM

Lufta kundër korrupsionit në Kosovë do të fitohet vetëm nëse ajo fiton karakter gjithënjëor dhe nëse këtë luftë pakompromis e përkrahin institucionet e Kosovës. Vetëdija qytetare duhet të ngritet në nivelin evropian. Tek të gjithë duhet të krijohet një bindje e përgjithshme se duke luftuar korrupsionin, ne luftojmë për: mbrojtjen e rendit ligjor, të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë, ndershmërisë dhe drejtësisë sociale, konkurrencës, rritjes ekonomike, besimit të përgjithshëm tek institucionet publike dhe vlerave morale të shoqërisë. Luftën kundër korrupsionit mund ta fitojmë nëse i lajmërojmë të gjitha rastet dhe nëse në këtë luftë kyçen të gjithë.



Mbështetja e OSBE-së Kuvendit të Kosovës

Shtator– Tetor 2006

Franklin De Vrieze, *Misioni i OSBE-së në Kosovë*

Kryesia e Kuvendit viziton Sllovakinë

Prej 17 deri me 19 shtator, Kryesia e Kuvendit të Kosovës bëri një vizitë studimore në Lubjanë, Slloveni. Pas kërkesës nga Zyra e PSSP-së, OSBE-ja u pajtua që ta sigurojë mbështetjen për vizitën dhe ta shoqërojë delegacionin në Lubjanë.

Anëtarët e Kryesisë u takuan me Kryetarin e Kuvendit Nacional të Sllovenisë, z. Franc Cukjatin, kryesuesin e Komisionit për politikë të jashtme, zëvendës-sekretarin e përgjithshëm të Kuvendit, zëvendësministrin e jashtëm dhe kryesuesin e departamentit të Kuvendit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe protokoll.

Me këtë rast, kryetarët Berisha dhe Cukjati ranë dakord për nevojën e bashkëpunimit ndër-parlamentarë, duke bërë të ditur njëherësh se në të ardhmen duhet të mbahet një takim i përbashkët i delegacioneve të disa parlamenteve të rajonit. Pos kësaj, anëtarët e delegacionit të Kuvendit të Kosovës, përfituan nga rasti që të mësojnë nga përvoja e Kuvendit të Sllovenisë, duke parashtruar një sërë pyetjesh lidhur me miratimin e buxhetit të Kuvendit, zgjedhjen dhe mandatin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, procedurën e përcaktimit të agjendës për seancat plenare, drejtimin e debateve plenare, si dhe funksionimin e seksionit të protokollit të Kuvendit. Vizita e ka arritur qëllimin e zhvillimit të bashkëpunimit rajonal midis parlamenteve dhe mësimin nga përvojat e homologëve, dhe OSBE-ja mbetet e gatshme të vazhdojë me ndihmën për Kuvendin e Kosovës për organizimin e vizitave të tjera.

Kuvendi i Kosovës debaton rreth mbikëqyrjes parlamentare të aktiviteteve të shërbimit informativ

Me 27 shtator, Qendra për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) dhe Kuvendin e Kosovës, mbajti një seminar me titullin “Mbikëqyrja parlamentare e aktiviteteve të shërbimit informativ”¹. Në këtë takim morën pjesë Komisioni për siguri, i themeluar kohëve të fundit, shefat e grupeve parlamentare dhe shërbyesit civil të sektorit të sigurisë në zyrën e Kryeministrit.

Në fjalën hyrëse, Zëvendës kryesuesi i Misionit të OSBE-së, Dr. Jens Modvig, përgëzoi Kuvendin për përparimin e bërë në ushtrimin e kontrollit demokratik mbi sektorin e sigurisë madje edhe para marrjes së kompetencave që janë planifikuar të transferohen nga UNMIK-u, nga mbikëqyrja e sektorit të emergjencës, tek

mbikëqyrja e policisë, dhe tani tek mbikëqyrja e sektorit të shërbimit të inteligjencës. Ndërkaq, kryesuesi i Komisionit për siguri, z. Naim Maloku, vuri në dukje se ai shpreson se ky seminar do t'i ndihmojë Kuvendit, që të gjejë mënyrën se si të punojë me disa agjenci ekzistuese të informimit, që të mësojë nga përvoja e vendeve të tjera në tranzicion, që të përparojë në punën rreth hartimit të ligjit për shërbimin informativ dhe që të jetë më efikas në luftën kundër krimit të organizuar. Gjatë ditës, në tri nëngrupet e tryezës së rrumbullakëta, komisioni diskutoi edhe për çështjet si sistemi i përgjithshëm i mbikëqyrjes, ruajtja e të dhënave, dilema midis transparencës dhe mbikëqyrjes kundruall sigurimit të sekreteve të punës dhe verifikimit të deputetëve. Pos kësaj, OSBE-ja do të shqyrtojë mundësinë e mbajtjes së një debati publik rreth kërcënimeve për destabilizim, si dhe përgatitjet për hartimin e pakove të tjera ligjore. Ndërsa, në Kuvend kanë filluar punën dy këshilltarë nga DCAF-i për të ndihmuar punën e Komisionit për siguri, sipas këshillave të OSBE-së.

Me 19 tetor, seanca plenare e Kuvendit ka debatuar lidhur me raportin e parë të Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi situatën e sigurisë në Kosovë. Ky raport fillimisht është diskutuar në Komisionin e sapoformuar të sigurisë, dhe shumica e anëtarëve të komisionit i kanë paraqitur vërejtjet e tyre gjatë seancës plenare.

Seminar i ekspertëve mbi procesin kushtetues

Me 29 shtator në Prishtinë, OSBE-ja organizoi një seminar të ekspertëve për procesin kushtetues. Ky seminar paraqet vazhdim të aktiviteteve të Tryezës së Rrumbullakët të Parlamentarëve dhe Ekspertëve për Çështje Kushtetuese (PERCI), të mbajtur prej 20 deri 22 korrik në Shkup.

Gjatë fjalës hyrëse, Shefi i Misionit të OSBE-së, Ambasadori Vnenti vuri në dukje rëndësinë e procesit kushtetues; si edhe vetë përmbajtja e tij. Siç theksoi ai, gjatë këtij procesi duhet të ndërtohet koncenzi politik si dhe përkrahja e popullit me qëllim të lehtësimit të zbatimit të Kushtetutës dhe funksionimit të duhur të strukturës shtetërore. Meqë kushtetuta e re do të duhet të përfshijë edhe çështjet për të cilat është rënë dakord gjatë negociatave për status, atëherë për hartimin zyrtar të saj duhet të pritur rezultati i bisedimeve statusore, që ka të bëjnë me çështjet e decentralizimit, trashëgimisë kulturore, të drejtat e komuniteteve dhe çështjet ekonomike. Kushtetuta do ta hapë rrugën për mbajtjen e zgjedhjeve gjë që do ta kompletojë tranzicionin politik.

Në këtë seminar morën pjesë edhe dy ekspertë ndërkombëtarë nga Estonia. Z. Juri Adams, ish Ministër i drejtësisë në qeverinë e Estonisë, ish kryesues i Komisionit për çështje ligjore të Kuvendit të Estonisë dhe znj. Lia Hani, ish anëtare e qeverisë së Estonisë dhe ish anëtare e Kuvendit Kushtetues të Estonisë. Pjesëmarrja e tyre ishte një mundësi dhe rast i mirë për të shkëmbyer përvoja me një shoqëri që së voni ka kaluar jo vetëm nëpër një tranzicion sfidues demokratik, por edhe nëpër procesin e hartimit të kushtetutës.

Gjatë diskutimit, pjesëmarrësit u pajtuan me vlerësimin e përgjithshëm se qëllimi kryesor i procesit kushtetues është që të sigurohet legjitimiteti i tij duke i respektuar parimet e transparencës dhe gjithëpërshirjes. Së këndejmi, pjesëmarrësit diskutuan rreth asaj se cili organ duhet ta hartojë dhe shqyrtojë Kushtetutën dhe erdhën deri tek përfundimi se pjesëmarrja e publikut dhe informimi i qytetarëve janë pjesët më kryesore dhe më të rëndësishme të këtij procesi. Ndërsa, në fokus të vëmendjes së diskutimeve ishin edhe mekanizmat për përfshirjen e të gjitha komuniteteve si dhe sigurimi se brengat e tyre do të merren parasysh gjatë procesit kushtetues.

Me 30 shtator, Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha, anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, shefat e grupeve parlamentare dhe anëtarët e grupit politik-strategjik të Grupit Negociator të Kosovës u takuan për të diskutuar lidhur me konkluzionet e tryezës së rrumbullakët të ekspertëve si dhe për të shqyrtuar opsionet për gjetjen e rrugës për të ecur përpara në rrafshin politik.

Programi për praktikë me grupet parlamentare në Kuvend

Raundi i tretë i programit për praktikë me grupet parlamentare ka filluar më 2 tetor dhe do të zgjas deri në fund të vitit. Ky projekt është një pjesë e rëndësishme e mbështetjes së Misionit të OSBE-së në Kosovë për mbështetjen e grupeve parlamentare. I zbatuar përmes Memorandumit të Mirëkuptimit të

Misioni i OSBE-së në Kosovë është duke menduar rreth iniciativave të mëtejme për ndërtimin e kapaciteteve për të mbështetur dhe për të siguruar një proces kushtetues gjithëpërshirës dhe transparent në bashkëpunim me faktorët vendorë dhe sipas udhëzimeve politike nga ICO, UNOSEK, vendet e Grupit të Kontaktit dhe UNMIK-u.

Në konferencën rajonale parlamentare në Zagreb u debatua mbi drejtësinë dhe sigurinë

Më 16 tetor, deputetët e Kuvendit të Kosovës u ftuan të marrin pjesë në konferencën për bashkëpunimin rajonal të parlamenteve të organizuar nga "trojka parlamentare", të përbërë nga Parlamenti Evropian, Kuvendi Parlamentar i OSBE-së dhe Tryezës së Punës I të Paktit të Stabilitetit. Grupi punues mbi Reformën Gjyqësore u fokusua në reformat e nevojshme si pjesë e procesit të integritimit në BE të vendeve të Evropës Juglindore. Veçanërisht mësimet e mësuara nga procesi i shpejtë i reformimit në Rumani tërhoqën vëmendjen dhe inicuan një debat interesant për rolin e parlamentit në mbështetje të reformës gjyqësore. Grupi punues mbi kontrollin parlamentar të sektorit të sigurimit në Evropën Juglindore shqyrtoi poashtu përvojën rajonale. Ky grup punues u fokusua në metodologjinë e Reformës së Sektorit të Sigurisë (RSS), me kontribute nga puna gjithëpërshirëse e OECD-së mbi udhëzimet për Reformën e Sektorit të Sigurisë dhe Qeverisjes.

nënshkruar ndërmjet OSBE-së dhe Kuvendit, praktikantët e kanë nënshkruar kontratën drejtpërdrejtë me Kuvendin, gjë që paraqet një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të këtij programi. Pas trajnimit dyditor, prej 3 deri më 4 tetor, të mbajtur nga OSBE-ja në bashkëpunim me Departamentin Ligjor të Kuvendit dhe Institutin Kombëtar Demokratik, praktikantët kanë filluar të përgatiten për organizimin e konferencave mbi politikën, që do të mbahen nën patronatin e grupeve përkatëse parlamentare të tyre.



Fokusimi në planin e veprimit kundër korrupsionit

Më 12 shtator dhe 17 tetor, OSBE-ja organizoi dy takime pune në mbështetje të Planit Qeveritar të Veprimit Kundër Korrupsionit (ACAP). ACAP-i u shpall nga kryeministri më 7 shkurt të vitit 2006. Ai përbëhet nga përcaktimi kohor për masat legjislative, administrative, policore dhe gjyqësore si dhe veprimet që kanë për qëllim fuqizimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit. Folësit në këtë takim pune qenë: Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit i cili diskutoi për zbatimin e masave legjislative dhe administrative të ACAP-it; Z. Fron Nahzi nga Instituti për Menaxhim Lindje-Perëndim rreth pasojave të korrupsionit për Kosovën; Z. André Vandoren, Zëvendës Prokurori i Përgjithshëm nga Belgjika, mbi strategjinë belge kundër korrupsionit; Prokurori Besim Kelmendi, Kryetar i Këshillit Anti-korrupsion, mbi rolin e këtij organi mbikëqyrës; profesorët Muhamet Mustafa dhe Ekrem Beqiri rreth rezultateve të fundit për korrupsionin në Kosovë dhe pasojat ekonomike të tij. Veç kësaj, një gazetar i KTV-së foli për raportimin e tij medial, i cili mbulon korrupsionin në sektorin e shëndetësisë. Në punëtorinë e dytë është prezantuar publikimi 'ACAP – Domosdoshmëri sociale dhe ekonomike për Kosovën'. Konkluzionet kryesore nga diskutimet përfshijnë njohjen e nevojës për një qasje gjithëpërfshirëse shumëvjeçare dhe prioritetin e fuqizimit të kapaciteteve hetuese dhe prokurorisë të gjyqësorit. OSBE-ja edhe më tutje do ta mbështesë ACAP-in përmes "programit për zhvillim profesional" për grupe të caktuara dhe përmes fushatës për informimin e publikut.

Mbështetja e Komisionit për Arsim

OSBE-ja i ka ofruar këshillime të ekspertëve dhe asistencë teknike Komisionit për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport të Kuvendit të Kosovës për formulimin dhe rishikimin e legjislacionit lidhur me arsimin dhe trajnimin profesional. Ky Këshill është në proces të hartimit të Ligjit mbi kualifikimin, që do të siguroj bazë ligjore për zhvillimin e një kornize për kualifikim me qëllim të sigurimit të cilësisë në sistemin e arsimit të Kosovës. Vlen të vihet në dukje se ky Komision ka shfrytëzuar Konceptin për kornizën kualifikuese, të përgatitur nga grupi i ashtuquajtur "Grupi i Dublinit", grup i ekspertëve nga sektorë të ndryshëm të IPVQ-ve, komuniteti afarist dhe sindikata, pas një vizite studimi në Irlandë të financuar nga Bashkësia Evropiane në vitin 2005. OSBE-ja dëshiron t'ia ofrojë mundësinë Komisionit për arsim për t'i vizituar institucionet relevante të arsimit në Dublin.

Mbledhje e përgjithshme e Iniciativës për Mbështetje të Kuvendit (ASI)

Më 2 tetor, është mbajtur një takim i përgjithshëm i ASI-t me pjesëmarrje të bashkëpunëtorëve të ASI-t, përfaqësuesve të Kuvendit

dhe agjencive donatore. Organizatat bashkëpunëtoresh të ASI-it prezantuan projektet e tyre në vijim e sipër me Kuvendin e Kosovës, programet e tanishme në IPVQ të agjencive donatore dhe diskutuan me përfaqësuesit kryesorë të bashkëpunimit të Kuvendit me partnerët e ASI-it.

Në fund të muajit shtator, është publikuar edicioni i 24 –të i buletinit ASI. Ky publikim është duke u rishtypur si shtojcë e gazetave ditore Zëri dhe Express (në shqip), javoret Gradjanski Glasnik (në serbisht) dhe Yeni Donem (në turqishte) dhe mujoren Alem (në boshnjakisht). Veç kësaj, edhe "Matrica² e aktiviteteve të ASI-it" është azhurnuar dhe shpërndarë. Konferenca rreth mbikëqyrjes parlamentare të qeverisë që organizohet me 13-14 nëntor, projekt i financuar nga AER-i në Kuvend, mbështetet edhe nga OSBE-ja dhe NDI.



Mbështetja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve (KDIK)

Në fund të muajit tetor, OSBE-ja filloi projektin e ri me qëllim të fuqizimit të kapacitetit të KDIK-së për të punuar në baza konsensuale dhe çështje konkrete të interesit për komunitete. Aktivitetet e projektit përfshijnë lehtësimin e ndërveprimit ndërmjet KDIK-së dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim përmes organizimit të një tryeze të rrumbullakët dhe për t'i bërë së bashku faktorët relevant vendorë dhe ndërkombëtarë që merren me komunitetet në Kosovë, për organizimin e tre debateve publike në komunat me pjesëmarrjen e anëtarëve të KDIK-së; dhe mundësinë për një vizitë studimi jashtë vendit gjatë muajit dhjetor.

¹Seminari është bazuar në doracakun e DCAF-it "Krijimi i një shërbimi inteligjent të përgjegjshëm: Standardet ligjore dhe praktikatat më të mira për mbikëqyrjen e shërbimeve informative".

²Matrica e aktiviteteve të ASI-t është një pasqyrim i seancave dhe këshillave trajnuese, seminareve, vizitave në vijim për këshillim dhe atyre të jashtme parlamentare

Komisioni për Bugjet dhe Financa përpilon propozimin për buxhetin e Kuvendit për vitin 2007

Edmond Efendija (NDI) / Instituti Kombëtar Demokratik



Siç është paraparë me Planin për Standarde Kuvendit, të iniciuar nga Kryetari Berisha dhe të miratuar nga Kuvendi në Qershor të këtij viti, si dhe sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Rregulla 6.7, Komisioni parlamentar për Buxhet dhe Financa ka përgjegjësinë që, së bashku me mbështetjen e Zyrës për Buxhet në Kuvend, të hartoj propozimin për buxhetin e Kuvendit të cilin e miraton Kryesia e Kuvendit. Pas miratimit Kryesia ia përcjellë propozimin Ministrisë për Ekonomi dhe Financa e cila e duhet të përpiloj projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka ndjekur një proces gjithëpërfshirës dhe transparent në përpilimin e propozimit për buxhetin e vitit 2007. Komisioni ka organizuar një sërë seancash dëgjimore me kryetarët e grupeve parlamentare, kryetarët e komisioneve parlamentare dhe zyrtarët e lartë nga Sekretariati i Kuvendit. Prej të gjithë pjesëmarrësve është kërkuar që të parashtrihen nevojat e tyre të cilat do të ndihmonin një funksionim më të mirë të trupave punues dhe administratës së Kuvendit.

Nga ana e pjesëmarrësve në seancat dëgjimore janë theksuar nevojat të ndryshme siç janë: ekspertët e lartë ligjor për komisionet dhe grupet

parlamentare, nevojat për të angazhuar ekspertë që ndihmojnë në hartimin e projektligjeve që dalin nga Kuvendi dhe ekspertë të fushave të ndryshme në baza të përkohshme, si dhe një vijë e veçantë buxhetore që shërben për aktivitetet e komisioneve parlamentare.

Si rezultat i këtij proces, komisioni ka propozuar një draft të buxhetit i cili ka disa risi në krahasim vitet e kaluara:

1) Komisionet parlamentare kanë një buxhet të veçantë të cilin mund ta shfrytëzojnë për aktivitetet e tyre dhe për të angazhuar ekspertë në baza të përkohshme.

2) Kuvendi do të krijoj një zyrë të re me ekspertë të lartë ligjor dhe për çështje të analizave financiare, të cilët do të jenë në shërbim të të gjitha komisioneve parlamentare.

3) Grupet Parlamentare do të shfrytëzojnë së paku 5% të fondeve të cilat jepen për partitë politike nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës.

4) Janë ndarë mjete të cilat do të shfrytëzohen për avancimin e aftësive të stafit të Kuvendit.

Besojmë se të gjitha këto risi do të ndihmojnë në një funksionim më të mirë të Kuvendit në përgjithësi.

Mendojmë se buxheti i Kuvendit për vitin 2007 (nëse miratohet ashtu siç është propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa) do të jetë më afër përmbushjes së nevojave të Kuvendit, dhe për këtë puna e komisionit por edhe e Zyrës së Kryetarit të Kuvendit meriton lëvdata.

Çështja e bërjes së buxhetit mund të avancohet edhe më tutje. Buxheti i një organizate duhet t'i shërbej realizimit të misionit dhe objektivave që dalin nga misioni i saj. Do të ishte mirë sikur Kuvendi të kishte një plan strategjik i cili do të përcaktonte qartë objektivat afatgjata dhe afatshkurta të Kuvendit. Secila legjislaturore ka si pjesë të misionit përfaqësimin e mirë të qytetarëve, miratimin e ligjeve cilësore dhe sigurimin e një mbikëqyrjeje parlamentare të punës së qeverisë. Në këtë drejtim, ka ende për t'u dëshiruar.

Në fund duhet të theksojmë së është shumë pozitiv fakti që në këtë vit, gjatë përpilimit të buxhetit të Kuvendit kanë qenë të inkuadruar aktivisht të gjithë aktorët relevantë në Kuvend dhe procesi i përcaktimit të prioriteteve ka qenë i hapur për të gjithë. Kjo është një praktikë e mirë e cila duhet të vazhdohet dhe avancohet.

Procesi i cili është ndjekur për hartimin e buxhetit të Kuvendit për vitin 2007

është një praktikë e re në

Kuvend dhe paraqet një hap

të rëndësishëm përpara. Si

çdo organizatë tjetër, Kuvendi

duhet të krijoj një proces i

cili siguron një buxhet që i

adreson nevojat e vërteta dhe

ndihmon në përmbushjen e

misionit të tij.



Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respek-timin e rregullave demokratike të punës, transparencës dhe përgje-gjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respektin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevojat në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinatori i ASI-t Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregullt i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt.) Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës, Sllovenisë dhe Institutin për Mbrojtje të Parisit, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB-ve (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.



Këshilli redaktues:

Sven Lindholm, Franklin De Vrieze, Skender Durmishi, Blerim Vela, Alfons Lentze, Chris Cycmanick, Ramë Manaj, Edmond Efendija, Krenar Loshi, Mahir Shehu, Valdet Sadiku.

Grafika dhe faqosja: Edi Agagjyshi

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt: franklin.devrieze@osce.org
<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij bulletini:

OSBE: 1, 2, 11, 13, 17, 18, 19, 22 Kuvendi: 3, 4, 10, 15, 16
EAR: 5 Liia Hanni: 8 Parlamenti Estonez: 9 NDI: 23